



Deklarata Mjedisore e Projektit Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri

Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor e Social (VNMS)

PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

JOB NUMBER: 5049164			DOCUMENT REF: 5049164 ANTEA Non-Technical Summary alb.doc			
Final Draft	Project Antea ESIA: Non-Technical Summary - Albanian	Originated NB / NK	Checked NB	Reviewed NB / TD (Antea)	Authorised AGI	Date March 2008
Revision	Purpose Description	ATKINS				

Informacion i Përgjithshëm

Antea Cement, pjesë e kompanisë greke Titan Group, propozon ndërtimin e një objekti të prodhimit të cimentos në Shqipëri, ndërtuar e drejtuar sipas standardeve të njohura botërore të projektimit dhe teknologjisë. Objekti do të jetë në gjendje të prodhojë 3 300 ton klinker në ditë (ton/ditë) (përbërësi kryesor i cimentos) dhe do të përfshijë shfrytëzimin e dy karierave për prodhimin e lëndës së parë. Vendodhja e zhvillimit të propozuar është pranë zonave të banuara të Burizanës, Picragës dhe Bretit, në Shqipëri. Kjo *Përmbledhje Jo-Teknike* pershkruan ndikimet bazë të zhvillimit të propozuar në mjedisin përreth dhe banorët vendas gjatë fazës ndertimore, operationale dhe nxjerrjes jashtë përdorimit.

Zhvillimi do të financohet pjesërisht nga Banka për Evropianë për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Korporata Financiare Ndërkombëtare (KNF). BERZH dhe KNF e kategorizojnë këtë projekt si projekt 'A' nga. Projektet e kategorisë 'A' kërkojnë një *Vlerësim të Ndikimit Mjedisor e Social (VNMS)*. Gjetjet e VNMS janë publikuar në *Deklaratën Mjedisore*, pjesë e së cilës është edhe kjo *Përmbledhje Jo-Teknike*. Gjithashtu është hartuar një Plan i Konsultimit dhe Komunikimit me Publikun (PKKP), i cili nxit procesin e konsultimit me publikun.

Meqenëse bankat investitore po konsiderojnë pjesëmarrjen e tyre në sipërmarrjen e Antea Cement, ata shprehin interesim të vecantë në çështjet e mëposhtme:

- Të gjitha ndikimet e mundshme mjedisore dhe potenciale janë marrë në konsideratë si dhe janë vlerësuar, aty ku gjykohen të parashikueshme;
- Zhvillimi i propozuar është i sigurt dhe i qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore dhe sociale përse i përket ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale; dhe
- Konsultimet me publikun mbi projektin dhe ndikimet e tij janë kryer për një periudhë prej 60 ditësh. Kjo është kryer nëpërmjet publikimit të Deklaratës Mjedisore.

Përmbajtja e Deklaratës Mjedisore vijon si më poshtë:

- Përshkrimi i objektit të propozuar dhe kushtet ekzistuese mjedisore në vendin e propozuar të zhvillimit;
- Vlerësimi i ndikimeve të zhvillimit të propozuar mbi mjedisin ekzistues dhe banorët vendas;
- Rekomandime për marrjen e masave me qëllim kufizimin e këtyre ndikimeve (masa zbutëse); dhe
- Përshkrimi i ndikimit të mbetjeve të mbetura në mjedis pas zbatimit të masave zbutëse të propozuara.

Disponueshmëria e Dokumentit të VNMS

Dokumenti i VNMS mund të sigurohet në format e mëposhtme:

- Përmbledhja Jo-Teknike do të shpallet në faqen e internetit të BERZH (ëëë.ebrd.com) dhe KFN (ëëë.ifc.org), të cilat gjithashtu do të përmbajnë informacion se ku ndodhet dokumenti i plotë i VNMS si dhe një link për t'ju referuar faqes së internetit të Antea Cement.
- Dokumenti i plotë i VNMS dhe Përmbledhja Jo-Teknike do të jenë të disponueshme në gjuhen angleze dhe shqipe pranë zyrës së Antea-s (Rruga e Durrësit (Ish Uzina Tirana) Pallati "Lim-Em" Shkalla 4D, Zyra Nr. 1, Tiranë, Shqipëri), nën drejtimin e znj. Teuta Dobi, Telefon 00355 4 230402. Kopje të dokumentit të plote të VNMS do të ruhen gjithashtu edhe në Këshillin Bashkiak të Krujës si dhe në Këshillin e Komunës së Thumanës.
- Gjetjet e VNMS do t'i prezantohen publikut nëpërmjet një ekspozite dhe prezantimi të shkurtër që do të mbahet në dy qendra pranë objektit të propozuar. Materialet e ekspozitës do të lihen në dispozicion të publikut për disa ditë në mënyrë që publiku të ketë mundësi të njihet me to. Gjatë kësaj kohe do të organizohet një prezantim si dhe një seancë me pyetje e përgjigje, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Antea-s si dhe ekspertëve mjedisorë e socialë.
- PKKP do të jetë e disponueshme në zyrën e lartpërmendur, në Eorl Bank Group Info Shop (www.worldbank.org), në Qendrën e Informacionit të Biznesit të BERZH-it në Londër dhe Zyrës Përfaqësuese në Tiranë, në faqen e internetit të BERZH (www.ebrd.com), si dhe në faqen e sponsorit të projektit (www.titan-cement.com).

- Kopje të materialit mund të sigurohen gjithashtu edhe nga zyra rajonale e BERZH-it në Tiranë.

Vendodhja e Zhvillimit të Propozuar

Fabrika e çimentos dhe karierat shtrihen në komunën e Picrragës, pranë fshatit të Borizanës, në verilindje të Tiranës. Vendndodhja e dy karierave është miratuar nga autoritetet vendore dhe VNMS ka marrë në konsideratë mundësinë e ngritjes së fabrikës së çimentos pranë njëres prej karierave. Vendndodhja e propozuar e karierave dhe fabrikës së prodhimit të çimentos ka karakter rural. Ka një sërë qendrash të banuara në një distancë prej 10 km nga zona e zhvillimit, duke përfshirë edhe qendrat rurale të banimit të Borizanës dhe Picrragës. Figurat 1 dhe 2 ilustrojnë vendndodhjen e propozuar të fabrikës së çimentos dhe karierave.

Hyrja automobilistike në Burizanë bëhet nëpërmjet një rruge të vogël që përshkon qytetin, e kalon pranë një shkolle. Momentalisht, kjo rrugë shfrytëzohet nga një karierë lokale. Kjo rrugë kon në një shteg të vështirë i cili është hapur për të mundësuar kalimin në zonën e karierës së gurit gëlqeror dhe fabrikës së cimentos. Si pjesë e planeve të zhvillimit propozohet shtrimi i një rrugë të re që lidh autostradën me fabrikën e cimentos. Shtegu për në këtë zonë përshkon një luginë të kufizuar nga male të thepisura përgjatë një terreni të ashpër. Terreni në të cilën ndodhet fabrika, është përcaktuar nga autoritetet vendore si zonë për zhvillim industrial. Itinerari i rrugës së propozuar ilustrohet në Figurën 3. Studimi mbi sigurinë rrugore u ndërmor, si pjesë e VNMS, për të vlerësuar rreziqet që përbëjnë për komunitetin rrugët e reja të automjeteve si dhe shfrytëzimi i tyre nga trafiku që gjenerohet nga zhvillimi i propozuar. Rezultatet e këtij vlerësimi diskutohen në seksionin mbi 'Cështjet Ekonomike dhe Sociale' të kësaj përmbledhjeje.

Zona, ndonëse është përcaktuar si zonë industriale, nuk ka objekte ekzistuese në afërsi të fabrikës së propozuar. Gjithësesi, në një distancë prej rreth 6km në lindje të fabrikës së propozuar, pranë qytetit historik të Krujës, ndodhet një fabrikë e madhe cimentoje dhe një karriere e gurit gëlqeror. Fabrika e cimentos ndodhet në rrafshinë dhe në përmasa të ngjashme me fabrikën që propozon Antea. Kjo fabrikë cimentoje nuk shtrihet pranë karierës por disa km në veri të saj. Kariera shtrihet në rrugën që të shpie në qytetin e Krujes. Fabrika e cimentos shtrihet në pllajën poshtë Krujës.

Projekti Antea:


Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vleresim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Figura 1 - Vendodhja e Projektit të Propozuar: Pamje e Zonës në Shkallë Kombetare



Figura 2 - Vendodhja e Projektit të Propozuar: Pamje e Zonës në Shkallë Vendore




Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Figura 3 - Vendodhja e Rrugës së Propozuar të Automjeteve që lidhet me Fabrikën e Cimentos




Panoramë e Prodhimit të Cimentos

Fabrika e propozuar do të prodhojë cemento nga lëndët e para që nxirren nga karierat në afërsi të fabrikës. Lëndët e para ngrohen në temperatura shumë të larta duke shkaktuar reaksione termike që prodhojnë klinkerin e cimentos. Klinkeri më pas bluhet duke prodhuar në këtë mënyrë cimenton për shitje. Më poshtë do të gjeni një Diagram të Procesit Zinxhir i cili ilustron procesin. Një përmbledhje e shkurtër për secilën fazë të procesit të prodhimit paraqitet si më poshtë:

- **Nxjerrja e Lëndës së Parë:** Lënda e parë nxirret nga karierat vendore. Lënda e parë kryesore përbëhet nga: guri gëlqeror (gips) dhe silikat-aluminat (një material argjilor i njohur ndryshe si “flish”). Pas nxjerrjes, lënda e parë ngarkohet e transportohet për në zonën e fabrikës së cimentos me transportierë. Për të parandaluar përhapjen e pluhurit gjatë transportit, përgatitja e lëndës së parë do të kryhet në një mjedis të kontrolluar në fabrikën e cimentos. Procesi i fraksionimit nuk do të kryhet në karierë. Në rast se ka përhapje rastësore të pluhurit në karriere gjatë transportit të lëndës së parë të nxjerrë nga karierat, lëndët dhe rrugët do të spërkatën me ujë për të parandaluar ngritjen e pluhurit nga era.
- **Përgatitja e Lëndës së Parë:** Pasi lëndët e para kanë mbërritur në fabrikën e cimentos, ato thërrmohen në impiante të vecanta fraksionimi për të prodhuar madhësinë e duhur të gurit për procesin e prodhimit të cimentos. Për të minimizuar përhapjen e pluhurit në grykat e impianteve thërrmuese, do të përdoren perde uji. Materialet e thërrmuara do të ruhen në pirgje të mëdha të mbuluara. Asnjë material i thërrmuar nuk do të ruhet në ambiente të jashtme. Pas procesit të fraksionimit, grumbullimit në pirgje dhe përgatitjes për furnizim, lënda e parë kalon në fazën e mëtejshme të procesit (faza para perzierjes) nëpërmjet dy hinkave/bunkerëve të vecanta furnizues.
- Prodhimi i cimentos kërkon gjithashtu edhe lëndë prej hekuri dhe bokside të cilat do transportohen në zonë nga burime të jashtme e do të ruhen në silose. Keto lëndë përdoren në sasira relativisht të vogla.
- Nga hinkat/bunkerët e furnizimit, lënda e parë kalon në impiantin e përpunimit të cimentos, ku lëndët bluhën imët. Para se të hyjnë në impiantin e përpunimit, secili material peshohet për të rregulluar përbërjen kimike të perzierjes. Lënda e parë e bluar (brumi) transportohet në silosin e homogjenizimit, ku përzihet (homogjenizohet), dhe nxirret prej saj sipas procedurave të përcaktuara teknologjike.
- Në të gjitha fazat e përgatitjes së lëndës së parë do të përdoren metodat e duhura për të parandaluar përhapjen e pluhurit, duke përfshirë konvejerë dhe vende depozitimi të mbyllura, minimizimin e rënies së materialeve, përdorimin e mekanizmave filtrues në impiantin e përpunimit të cimentos. Të gjitha mekanizmat filtrues janë projektuar për të siguruar përhapjen e grimcave nën 30 mg/Nm^3 , në përputhje me standardet industriale.

- **Përgatitja e Lëndës Djegëse në Trajtë të Ngurtë:** Prodhimi i cimentos kërkon një sasi të konsiderueshme energjie. Për të siguruar këtë energji, përdoren si lëndë djegëse, lëndë të tilla si qymyrguri, nafta, koksi apo linjiti. Lënda djegëse do të transportohet në fabrikë nga portet vendore, i cili në këtë rast ka shumë të ngjarë të jetë porti i Durrësit. Lënda djegëse që do të përdorë Antea duhet të jetë i nxjerrë jashtë vendit. Para djegies, lëndët djegëse, ashtu si lëndët e para, duhet të thërrmohen para se të furnizojnë procesin e prodhimit të cimentos.
- **Ngrohja e Lëndës së Parë:** Lëndët e para hidhen në impiant dhe ngrohen në temperatura të larta; si pasojë e reaksionit termik krijohet 'klinkeri' i cimentos. Fabrika e Cimentos Antea do të shfrytëzojë teknikat më moderne dhe eficiente për ndërmarrjen e këtij procesi. Lëndët e para fillimisht furnizojnë linjën e ngrohjes me një sistem me 5 faza që ngrohet nga gaze të nxehta gjatë fazës tjetër të procesit. Pjesa e fundit e linjës së ngrohjes quhet 'para-kalcinimi', ku digjet më shumë se gjysma e lëndës djegëse dhe ku ndodh pjesa më e madhe e reaksioneve kimike. Mikstura më pas hyn në një furrë të madh me shtrirje horizontale, vend në të cilin digjet pjesa tjetër e lëndës djegëse dhe ku ndodh pjesa e fundit e reaksioneve kimike në temperaturë të lartë. Klinkeri i përfutur duhet të ftohet para se të magazinohet.
- **Bluarja e Cimentos dhe Ruajtja:** Klinkeri bluhet me përbërës si (gipsi, pluhur hiri, gur gëlqeror) në varësi të kërkesave të cilësisë të produktit përfundimtar të cimentos. Më pas pluhuri i cimentos ruhet në silose të mëdha.
- **Ambalazhimi në Thasë dhe Shpërndarja:** Një pjesë e cimentos shitet e paambalashuar (rifuzo) e transportohet në transportiere të specializuara. Pjesa tjetër pakëtohet në një nga impiantet e paketimit në fabrikë para se t'u shpërndahet klientëve.

Figura 4 – Procesi Zinxhir: Prodhimi i Cimentos dhe Shfrytëzimi i Aktiviteteve Ndihmëse



Arsyet Përse Nevojitet Fabrika e Cimentos

Fabrika e propozuar e cimentos nevojitet pasi ajo:

- Do të jetë një burim i cmuar i prodhimit të cimentos për përdorim brenda vendit për të mbështetur zhvillimin e infrastrukturës dhe programin kombëtar të ndërtimit.
- Do të ulë nevojën e Shqipërisë për importin e cimentos nga jashtë dhe do të jetë një burim i prodhimit të cimentos që do të mund të eksportohet jashtë. Kjo do të ketë një efekt pozitiv në bilancin e pagesave, duke përmirësuar situatën financiare.
- Do të mundësojë hapjen e vendeve të punës dhe përmirësime në infrastrukturën lokale.

Alternativat e Shqyrtuara

Alternativat kryesore të zhvillimit të fabrikës së re të cimentos përmbledhen si më poshtë:

- Asnjë ndryshim: Kjo alternativë do të thotë që mjedisi lokal do të mbetet në gjendjen ekzistuese, disi të rrënuar, por kjo gjithashtu do të thotë që nuk do të ketë zhvillim ekonomik si pasojë e zhvillimit të fabrikës së cimentos.
- Vendosja e karierave dhe fabrikës diku tjetër: Është marrë në shqyrtim një terren pranë Torovicës e cila ka rezerva të mjaftueshme guri gëlqeror dhe flishi; por kjo vendodhje nuk u pranua për shkak të ndjeshmërisë së qendrave të banimeve dhe cështjeve të tjera që lidhen me infrastrukturën vendore dhe transportin e materialeve.
- Vendosja e fabrikës së cimentos pranë karierës së gurit gëlqeror: Ky është vendi më i përshtatshëm përse i përket furnizimit me lëndë të parë rifuzo, gur gëlqeror dhe lehtësi në daljen në arterien kryesore rrugore që kalon nga veriu në jug të Burizanes. Kjo zonë nuk ka ndjeshmërinë sociale dhe ekologjike të luginës së Picrragës; sidoqoftë, shtrirja në një terren bujqësor të rrafshët e në lartësi do të sigurojë mundësinë për të vrojtuar disa pjesë të fabrikës prej shumë km largësi nga disa pika të favorshme vrojtimi.
- Vendosja e fabrikës së cimentos pranë rezervave të flishit: Kjo do të rezultojë në një zhvillim të konsiderueshëm industrial në luginën e qetë të Picrragës dhe në transportin e sasive të mëdha të materialeve në distanca të gjata pasi fabrika do të jetë larg nga burimi i lëndës së parë kryesore, gurit gëlqeror. Zakonisht, fabrikat e cimentos vendosen pranë karierës së gurit gëlqeror.

Pjesët Kryesore të Zhvillimit

Karakteristikat kryesore të projektit janë:

- Ndërtimi i një objekti të prodhimit të cimentos dhe linjës së prodhimit të klinkerit në sasinë 3 300 ton/ditë. Ndërtimi do të përfundojë brenda vitit 2010 dhe do të ndërmerret kryesisht nga një furnitor specialist pajisjesh nga Kina. Ndërtimi i objektit ka nevojë për të paktën 700 punonjës kinezë.
- Hapja e karierave të gurit gëlqeror dhe flishit (silikat-aluminati) për të siguruar pjesën më të madhe të lëndës së parë për procesin e prodhimit.
- Hapja e rrugëve të reja dhe zhvillimi i rrugëve ekzistuese që lidhin:

Karrierën e flishit me fabrikën e cimentos

Fabrikën e cimentos me arterien kryesore rrugore automobilistike që përshkon Burizanën.

Sasitë e materialeve do të transportohen përgjatë këtyre rrugëve si dhe duke shfrytëzuar infrastrukturën e përcaktuar për transport. Transporti i materialeve do të bëhet me anë të automjeteve të tonazhit të rëndë.

Pjesë e zhvillimit është edhe ndërtimi i një nën-stacioni elektrik për të importuar energji në Shqipërinë veriore e për të lehtësuar furnizimin me energji të fabrikës së cimentos. Detajet e nën-stacionit elektrik e në veçanti itinerari potencial, janë marrë në shqyrtim gjatë kohës së shkrimit të raportit. Ndërtimi i nën-stacionit përbën një zhvillim strategjik kombëtar që kërkon një vlerësim të detajuar. Procedurat e vlerësimit si dhe të projektimit, ndërtimit dhe funksionimit të nën-stacionit elektrik do të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë ato që janë aprovuar nga BERZH dhe KFN.

Standardet e Projektimit dhe Funksionimit që janë Ndjekur për Zhvillimin

Kompania mëmë e Antea-s, Titan Cement, shpreh përkushtim ndaj zbatimit të të njëjtave standarde të projektimit dhe funksionimit të zhvillimit të propozuar si në zhvillime të tjera industriale në vende të tjera të botës. Kjo përkon edhe me kërkesat e partnerëve investitorë, BERZH dhe KFN.

Kriteret e projektimit dhe funksionimit të objektit janë mbështetur nën drejtimin e Bashkimit Evropian dhe Bankës Botërore. Bashkimi Evropian, mbi bazën e Direktivës së kontrollit të ndotjes (Parandalimi dhe Kontrolli i Integruar i Ndotjes i (96/61/KE)) ka përcaktuar një

parametër standard për aktivitetet industriale. Standardi lidhet me aspektet kryesore të projektimit dhe funksionimit të zhvillimit industrial dhe parashtrohet Teknikat më të Mira të Disponueshme (TMD) për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes. TMD janë detajuar për çdo aktivitet madhor industrial në një sërë dokumentesh që titullohen Udhëzimet e Bashkimit Evropian mbi TMD (BREF). Ka një udhëzim specifik BREF mbi prodhimin e cimentos i cili detajon standardin e përshtatshëm të projektimit dhe funksionimit të këtij sektori industrial. Ky është standardi kryesor i miratuar nga partneri investitor BERZH. Në mënyrë të ngjashme, Ekipi i Bankës Botërore (World Bank Group), nëpërmjet KFN, ka nxjerrë Udhëzimet mbi Mjedisin, Shendetin dhe Sigurinë, të cilat detajojnë një sërë kërkesash për projektimin dhe funksionimin e objekteve industriale. Këto udhëzime përfshijnë edhe udhëzime mbi industrinë e cimentos. Ky është standardi kryesor miratuar nga partneri investitor KFN. Të dy tipet e materialeve udhëzuese plotësojnë njëra-tjetrën.

Rëndësi të vecantë në projekt luajnë shkarkimet në ajër dhe sigurimi se fabrika do të plotësojë parametrat etalon për shkarkimet në ajër. Oksidet e azotit janë të një rëndësie të vecantë kur flitet për kontroll të shkarkimeve nga fabrika e cimentos. Operatori pohon se fabrika do të projektohet dhe do të funksionojë në përmbushje të standardeve të vlerave kufizuese të Bankës Botërore, sic parashikohen në Udhëzimet mbi Mjedisin, Shendetin dhe Sigurinë për Përpunimin e Cimentos; ndaj, shkarkimet/clirimet nga fabrika e cimentos nuk duhet të tejkalojnë:

- Grimcat 30 mg/Nm³
- Oksidet e Azotit (NO_x) 600 mg/Nm³
- Oksidet e Squfurit (SO_x) 400 mg/Nm³

Keto vlera kufizuese të shkarkimeve/clirimeve janë të krahasueshme me vlerat kufizuese që kerkohen në dokumentin BREF, me përjashtim të vlerës së Oksideve të Azotit. Vlera kufizuese e TMD të clirimeve të Oksideve të Azotit, sic parashikohet në dokumentin BREF, është 500 mg/Nm³

Kontrollet mbi të gjithë agjentët e tjerë ndotës gjithashtu duhet të jenë në përputhje me udhëzimet e parashtruara në standardet e lartpërmendura. Përqëndrimet maksimale për të tërë agjentët ndotës duhet të arrihen pa u holluar (dmth oxhaku kryesor të përmbajë vetëm përqendrimin e gazeve të procesit) dhe duhet të llogariten si një raport i orëve vjetore të punës, të paktën 95% të kohës që fabrika apo reparti po punon.

BE dhe Banka Botërore, ndryshe nga fabrika e cimentos, nuk kanë botuar standarde zyrtare mbi aktivitetet e shfrytëzimit të karierave të nxjerrjes së mineraleve. Për të vlerësuar nëse projektimi dhe shfrytëzimi i karierave është në standardin e duhur (dmth në përputhje me TMD), u ndërмор një vlerësim duke shfrytëzuar një numër dokumentesh nga Evropa, përfshirë udhëzime ligjore. Një nga dokumentet themelore që u shfrytëzua mban titullin “Praktika të Mira Mjedisore në Industrinë Evropiane të Nxjerrjes së Mineraleve: Një Udhërrëfyes”, prodhuar në interes të Bashkimit Evropian.

Krahas shfrytëzimit të standardeve ndërkombëtare të projektimit për fabrikën e cimentos, Antea do të zbatojë të njëjtat standarde për karierat ashtu sikurse operon kompania mëmë

në Evropë e Amerikë të Veriut, duke marrë në konsideratë ndjeshmërinë lokale gjatë fazës operacionale. Edhe partnerët investitorë, BERZH e KFN, presin të njëjtin nivel të manaxhimit e shfrytëzimit të karierave ashtu sikurse zhvillimet që kryhen në Evropë apo Amerikën e Veriut.

Ky informacion tregon se projekti i propozuar duhet të përshtatet me standardet e njohura botërore të projektimit dhe teknologjisë lidhur me prodhimin e cimentos dhe shfrytëzimin e karierave. Clirimet nga fabrika e cimentos duhet të përshtaten me udhëzimin mbi shkarkimet e lejuara, të përcaktuara nga BERZH dhe KFN, sic detajohet më lart. Lidhur me shkarkimin e oksideve të azotit, Antea shprehet se kompania do të operojë brenda këtyre limiteve pa nevojën e teknologjive lehtësuese për NOx. BERZH dhe KFN e kanë pranuar këtë propozim.

Projektimi dhe funksionimi i propozuar i fabrikës, siguruar nga operatori, dëshmon se fabrika, karierat dhe zhvillimet infrastrukturore do të jenë në përputhje me standardet përkatëse projektuese dhe operacionale të Bankës Botërore. Lidhur me shkarkimet/clirimet e oksideve të azotit, fabrika do të funksionojë në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe standardet ndërkombëtare të Bankës Botërore, por nuk do të mund të përmbajë kërkesat e TMD që shprehen në dokumentin BREF të Bashkimit Evropian. Vlerat kufizuese të shprehura në dokumentin BREF zakonisht arrihen nëpërmjet përdorimit të teknologjive lehtësuese. Antea shprehet se ata do të operojnë brenda vlerave kufizuese të Bankës Botërore, pa pasur nevojën e teknologjive zbutëse për NOx. Vlerësimi i modelimit të ndikimit të ajrit dëshmon se nuk do të ketë ndikime negative mbi cilësinë e ajrit si pasojë e clirimeve të propozuara të oksideve të azotit. Në fazën operacionale të fabrikës, operatori, në kuadër të planit të manaxhimit, do të kërkohet të ndërmarrë një vlerësim mbi ndikimin e clirimeve në ajër dhe mbi nevojën e përdorimit të teknologjive lehtësuese. Fabrika është projektuar në mënyrë të tillë që të ofrojë lehtësi në përshtatjen e teknologjive lehtësuese, nëse do të jetë e nevojshme në një periudhë të mëvonshme.

Këto çështje diskutohen më tej në raport në kapitujt që lidhen me vlerësimin e teknologjive të propozuara (Kapitulli 4) dhe në kapitullin mbi ndikimet në cilësinë e ajrit (Kapitulli 7). Kjo Përmbledhje Jo-Teknike përfshin edhe një përmbledhje të konkluzioneve të vlerësimit.

Kushtet e Mjedisit Ekzistues

Zona që rrethon territorin e propozuar për zhvillim ka një peizazh gjysmë-natyror rural me toka bujqësore me bimësi të ulët që bëjnë kontrast me tokat kodrinore e malore me bimësi shkurrësh. Mbizotërojnë vargmale të shpyllëzuara me zona karakterizuar nga erozion e shkurre, ngjyra e mbytur dhe struktura e thyer e të cilave kanë ndikuar ndjeshëm në karakterin e paizazhit. Vendbanime të vogla e prona private janë të përhapura në të tërë rajonin. Toka shfrytëzohet kryesisht për bujqësi. Zonat më kodrinore shfrytëzohen për kullota deri në pikën ku ato bëhen shumë të thepisura.

Zona e propozuar e zhvillimit të projektit (fabrika e cimentos dhe karierat) është një zonë e hapur ku mbizotëron bimësia e shkurreve e që shfrytëzohet ojesisht për kullotje, gjueti, mbledhje bimësh dhe si burim për dru zjarri. Lënda drusore përdoret gjithashtu si lëndë djegëse për procesin e prodhimit të shërbetit të gëlqeres si pasojë e djegies së gëlqeres. Djegia e gëlqeres kryhet në kariera të vecanta të përhapura në zonat malore të rajonit. Rezultat është një rajon pjesërisht i zhveshur nga bimësia me përjashtim të shkurreve të ulëta. Zhveshja nga bimësia është më e dukshme pranë fshatrave dhe në tokën bujqësore në shpatet e thepisura; pasi arrihet kjo fazë ekstreme (dmth përhapja e erozionit të tokës), zhveshja kap territoret me bimësi lulesh, ndërkohë që rehabilitimi i tokës dhe bimësisë arrihet pas vitesh të tëra.

Në mars 2007, një specialist i Atkins për identifikimin e kafshëve dhe një specialist i Universitetit të Tiranës për identifikimin e bimëve, kryen një vërtetim në terren për të identifikuar llojet e bimëve dhe kafshëve që jetojnë aktualisht në zonat e propozuara për zhvillim. Këto vërtetime në terren u mbështetën në hulumtime të shumta, kryesisht në vlerësimet e kryera më parë në zonë e rajon, mbi historikun e bimëve dhe kafshëve që hasen në këto zona.

Zona e Burizanës karakterizohet nga diversiteti ekologjik por habitatet e saj nuk janë unike. Habitatet dhe speciet e ngjashme hasen në vende të tjera, siç është rasti i Parkut Kombëtar të Dajtit. Gjithësesi, për shkak të zonës fitoklimatike në të cilën shtrihet Burizana dhe pavarësisht degradimit të saj, një sërë habitatesh të pasura me specie hasen në secilën vendodhje dhe përgjatë shtigjeve që propozohen për rruget e reja. Vizitat në terren nuk zbuluan ndryshime të mëdha në faunën e të dy vendodhjeve; ndërsa nga pikëpamja e bimësisë zona e flijit doli më e pasur, ndërsa pjesë të zonës së karierave të gurit gëlqeror janë në fazën më të ashpër të zhveshjes së bimësisë dhe erozionit të tokës. Të dy zonat e propozuara për kariera bëjnë pjesë në kategorinë e zonave me bimësi të ulët (nga 4 zona) që në Shqipëri quhen “pyjet dhe shkurret sklerofile me gjelbërim të përhershëm” (ose ‘bimësi tipike mesdhetare me gjelbërim të përhershëm’). Kjo zonë mund të ndahet më tej në 5 tipe bimësie të njohura (përfshirë makje dhe garriga), që përfaqësojnë faza të ndryshme të zhveshjes së bimësisë.

Në zonat e propozuara për zhvillim nuk ka habitatet e mbrojtura apo habitatet që konsiderohen si “Habitatet Kritike”, siç përcaktohen në Standardin e Performancës 6 të KFN-së “Konservimi i Biodiversitetit dhe Manaxhimi i Burimeve të Qëndrueshme Natyrore” – zona këto me vlera të larta biodiversiteti, përfshirë habitatet që nevojiten për mbijetesën e specieve shumë të rrezikuara apo të rrezikuara (në bazë të Listës së Kuqe të UBK-së mbi Speciet e Kërcënuara apo siç përcaktohen në legjislacionin kombëtar). Ndonëse disa bimë, zvarranikë dhe amfibë të gjetur në ose pranë zonave të projektit janë nën mbrojtje dhe gjenden në Listën e Kuqe të Shqipërisë apo UBK-së, këto specie janë të përhapura gjerësisht në nivel kombëtar dhe/ose evropian. Zvarranikët dhe amfibët që janë në Listën e Kuqe të UBK-së janë në kategorinë e specieve ‘më pak të rrezikuara’, ndërsa bimët nuk janë aspak në Listën e Kuqe të UBK-së.

Kushtet klimatike të zonës janë tipike mesdhetare, karakterizuar nga verë e nxehtë dhe e thatë e dimër i butë e i lagësht. Sasia e reshjeve vjetore në Burizanë është e lartë; në nivel kombëtar, niveli i reshjeve është nga 750mm në zonat bregdetare në 4,444mm në zonat malore. Terreni në zonën e Burizanës përshkohet nga një sistem i zhvilluar rrymash, lumenjsh e përrenjsh që derdhen në detin Adritatik. Lumi Droje mbledh ujin që zbret nga mali i Skënderbeut dhe Shëngjergjit dhe pasi kalon nëpër fshatin e Shpërdhetit hyjnë në një kanal artificial, i cili konsiston në një sistem kullues të fushave të fshatit Thumanë.

Ujrat tokësorë në Shqipëri janë tejet të rëndësishme si burimi i vetëm i ujit të pijshëm. Për shkak të pozicionimit të objektit të propozuar midis rrafshnaltës deltike bregdetare dhe maleve të thepisura, zona ka dy tipe rezervash ujëmbajtëse tokësore në nëntokën e rajonit. Këto janë rezerva ujëmbajtëse tejet poroze dhe rezerva ujëmbajtëse gëlqerore karstike. Ka një numër të konsiderueshëm të puseve ujore të shpuara e shfrytëzuara nga persona fizikë në rajonin midis Rinasit dhe Thumanës. Sasia maksimale e shfrytëzimit shkon në 500-600 l/sek ose 15,768,000 – 18,921,600 m³ në vit.

Efektet gjatë Fazës Ndërtimore

Kontraktuesi kryesor për zhvillimin është CBMI, një kompani bazuar në Kinë, me përvojë të konsiderueshme në zhvillime të tjera ndërtimore. Parashikohet një numër maksimal prej 700 punëtorësh që do të punojnë njëkohësisht si dhe planifikohet që ata të jetojnë në kampin e ndërtuar enkas për to. Kampi do të ngrihet pranë zonës së ndërtimit në lindje të Burizanës dhe do të ketë të gjitha objektet për t'i dhënë formë të plotë kampit, përfshirë qendrat argëtuese. Kampi i ndërtimit do të ketë ndërtesa parafabrike dhe infrastrukturë të nevojshme.

Aktivitetet ndërtimore do të përfshijnë:

- Përgatitja e zonës për ndërtim dhe sistemimi i terrenit dhe peizazhit;
- Lidhja e zonës me shërbimet komunale dhe publike;
- Hapja e themeleve / gërmime dhe derdhje betoni;
- Ngritja e strukturave prej celiku dhe veshja e tyre mbrojtëse;
- Montimi i pajisjeve;
- Ngritja e reparteve ndihmëse;
- Lidhja me shërbimet publike dhe komunale;

- Kontrolli teknik; dhe
- Autorizimi i përdorimit (brenda vitit 2010).

Ndikimi kryesor mbi ekologjinë që rezulton nga faza ndërtimore e projektit është humbja e bimësisë, shoqëruar me 'spastrimin' e të dy territoreve të karierave, fabrikës së cimentos, kampit të ndërtimit dhe ndërtimit të rrugëve të reja. Me heqjen e bimësisë dhe shtresave të dheut, do të prishen edhe vendbanimet e faunës (gjitarët, shpendët, zvarranikët, amfibët, vertebrorët) së bashku me cdo lloj specie tjetër që nuk mund të lëvizë prej andej kur të bëhet pastrimi i zonës.

Zhvendosja e bimësisë në shkallë të gjerë nuk është e mundur; sidoqoftë, krijimi i fidanishteve është praktikë e punës së Titan. Fidanët përdoren (i) për të siguruar ndarjen fizike të vendodhjes së karierave dhe fabrikës së cimentos, dhe (ii) për të rehabilituar zonën me bimësi. Krijimi i një ose më shumë fidanishteve në zonën e propozuar të projektit ndihmon në zbutjen afatshkurtër dhe afatgjatë për rehabilitimin brenda dhe jashtë terrenit të habitateve të dëmtuara.

Humbja e bimësisë në vendodhjet e karierave dhe fabrikës së cimentos nuk mund të shmanget, por rehabilitimi i suksesshëm, përmirësimi dhe manaxhimi afatgjatë i territoreve përreth për konservim dhe përdorim produktiv do të kompensohen më mënyrë të konsiderueshme. Vëmendje e vecantë duhet t'i kushtohet specieve të bimëve që do të kultivohen në fidanishte. Rehabilitimi i habitateve kërkon përdorimin e specieve autoktone krahasuar me speciet e tjera pyjore ekzotike dhe/ose komerciale, ndonëse speciet komerciale mund të jenë të rëndësishme në se ka nevojë për plantacione të kultivimit të pemëve. Vecanërisht, do t'i kushtohet rëndësi shumimit të specieve autoktone bimë medicinale apo specieve me përdorime të tjera praktike, dmth specie që preferohen nga komunitetet përreth. Gjithashtu, do të jenë të favorshme, speciet me vlera të njohura biologjike konservimi, dmth speciet e bimëve të rralla apo në rrezik dhe atyre që njihen si burim i rëndësishëm ushqimi bimor për faunën e egër, psh fluturat.

Kjo kërkon kryerjen e një "vërtetimi të habitateve dhe studimi të manaxhimit të tyre" në dhe përreth dy vendodhjeve:

- (i) për të vlerësuar në më tepër detaje tipin, përhapjen dhe kushtet e bimësisë ekzistuese (dhe shtresës sipërfaqësore të dheut);
- (ii) për të vlerësuar më mirë praninë dhe statusin e faunës, vecanërisht specieve me domethënie konservuese; dhe
- (iii) për të zhvilluar propozimet e manaxhimit të habitatit dhe specieve. Kjo kërkon konsultime të ngushta me ekspertet dhe komunitetet vendore për të siguruar se

kërkesat e tyre merren parasysh dhe se ato do të veprojnë në përputhje me cdo lloj praktike manaxhimi.

Propozohet mbledhja e farave dhe cdo lloj lënde tjetër shtimi (psh.: zhardhokët dhe bisqet) për fidanishten që do të vendoset në një zonë pranë zhvillimit industrial. Procesi i mbledhjes së lëndës së shtimit, shtimi i tyre në fidanishte dhe mbjellja e tyre do të kontrollohet nga një ekspert hortikulture (preferohet një person me përvojë apo interes në ekologji). Eksperti duhet gjithashtu të marrë pjesë dhe të kontribuojë në planin e shkulljes së bimëve nga zona e karrierës para se të fillojë shfrytëzimi i saj. Duke pasur njohuri mbi periudhën e shkulljes së bimëve dhe radhës së punës në aktivitetet e karrierës, cdo program për vrojtimin e faunës dhe bimësisë do të lidhen ngushtë me programin e zhvishjes së terrenit. Përveç ekspertit të hortikulturës, do të emërohet edhe një ekolog (me përkrahjen e aktorëve ndërkombëtarë në se ai/ajo nuk ka përvojë në zbutjen e efekteve ekologjike), për të kontribuar në studimin e manaxhimit dhe vrojtimin të habitatit, dhe për të vrojtuar dhe zhvendosur faunën, aty ku konsiderohet e nevojshme.

Lidhur me rrugët e hyrjes në zonën e karrierës do të hartohet një Metodologji Ekologjike, në bashkëpunim me projektuesin/kontraktuesin që do të rezultojë në një mekanizëm për të siguruar ekzistencën e masave të nevojshme mbrojtëse. Ndryshimet apo modifikimet në itinerarin e rrugëve dhe metodat e ndërtimit do të bëhen për të siguruar shmangien e zonave të ndjeshme, aty ku është e mundur, si dhe për të lejuar psh vendkalimet e përshtatshme të përrrenjve/lumenjve.

Lidhur me shkarkimet në ajër, aktivitetet ndërtimore mund të prodhojnë pluhura që mund të shkaktojnë shqetësim ndaj banorëve vendas dhe rrezik për shëndetin ndaj punëtorëve të ndërtimit. Megjithatë receptorët rezidencialë janë rreth 1 km larg nga zona kryesore e zhvillimit gjykohej se nuk do të ketë ndikime tek banorët vendas. Rreziku kryesor është ekspozimi i punëtorëve në terrenin e punës. Për të zbutur ndikimin, është mirë të përdoren masa për kontrollin e pluhurit dhe përdorimi i pajisjeve të mbrojtjes vetjake. Ndikimi i shkarkimit të gazeve të automjeteve mbi cilësinë e ajrit konsiderohet e papërfillshme.

Rezervat ujore në afërsi të zonës së ndërtimit mund të ndoten si rezultat i shkarkimit të materialeve që përdoren për ndërtim. Materialet ndotëse do të ruhen në ambiente të përshtatshme për të ulur rrezikun e incidenteve të ndotjes nga derdhjet apo rrjedhjet. Një impiant i madh i trajtimit të ujrave të zeza do të ndërtohet për të manaxhuar mbetjet e prodhuara në zonë, të cilat mund të jenë problematike vecanërisht gjatë fazës ndërtimore, që karakterizohet nga një numër të madh punëtorësh. Fabrika, e cila është në fazën e projektimit ndërkohë që po shkruhet ky raport, do të projektohet duke marrë në konsideratë kapacitetin e mbetjeve që do të prodhohen gjatë fazës ndërtimore dhe ky do të jetë kapaciteti i përhershëm për trajtimin e mbetjeve gjatë fazës operacionale të projektit. Mbetja perfundimtare do të jetë derdhet në një vendodhje, ende të papërcaktuar.

Për shkak të karakterit bujqësor gjysmë-natyror të territorit të propozuar për zhvillim, ndikimet e përkohshme vizuale të ndërtimeve mund të sjellin ndikime të pafavorshme për shkak të prezantimit të strukturave dhe pajisjeve të dukshme ndërtimore. Sidoqoftë, topografia e zonës do të sigurojë një nivel natyror të ekzaminimit të punimeve dhe terreni do të planifikohet për të minimizuar këto ndikime negative vizuale.

Efektet e trafikut që prodhohen gjatë fazës ndërtimore mund të shkaktojnë dëme mesatare nëse merret parasysh një fluks i ulët i automjeteve që përshkojnë zonën.

Së fundmi, nivelet e zhurmës ka të ngjarë të jenë të larta dhe cdo zhurmë që lidhet me aktivitetet ndërtimore ka të ngjarë të ketë ndikime të papërfillshme. Masat për uljen e niveleve të zhurmave të ndërtimit do të përfshihen në Planin e Manaxhimit të Mjedisit dhe Programin e Monitorimit.

Në përgjithësi, me përjashtim të ndikimeve mbi ekologjinë e territorit brenda zonës së zhvillimit, aktivitetet e ndërtimit janë të përkohëshme dhe konsiderohen të kenë ndikime të vogla mbi nivelin e pluhurave dhe mbi aspektet vizuale.

Efektet gjatë Fazës Operacionale

Efektet potenciale të zhvillimit të propozuar gjatë fazës operacionale ndahen si më poshtë:

- Ndikime në cilësinë e ajrit si rezultat procesit të prodhimit të cimentos si dhe nga pluhuri shkaktuar nga aktivitetet e karierave dhe proceset e fraksionimit dhe bluarjes. Gjithashtu ka edhe ndikime në shkallë ndërkombëtare si rezultat i cilimeve të gazeve atmosferike nga procesi i prodhimit.
- Ndikime lidhur me zhurmën, vecanërisht ndikimi i zhurmës përreth në receptorët njerëzorë.
- Ndikime të fabrikës dhe karierave nga ndryshimet peizazhore dhe ndikimet vizuale.
- Ndikime në ekologjinë vendore nga humbja e habitateve si pasojë e zhvillimit dhe ndikime të fazës operacionale në përbërjen ekologjike përreth.
- Ndikim në rrjetin e ujrave sipërfaqeve (sistemi hidrologjik) nga ndryshimet në sistemin e drenazhimit natyror të peizazhit brenda zonës së zhvillimit dhe përhapjes potenciale të grimcave të ngurta në ujë si rezultat i aktiviteteve industriale. Shkarkim potencial i mbetjeve të lëngshme të ndotura në sistemin e drenazhimit të ujrave sipërfaqësore. Gjithashtu, ndikime në ujrak nëntokësore, quajtur ndryshe ujrak tokësore (sistem hidrogeologjik) si rezultat i nxjerrjes së ujit për proceset industriale.

- Shfrytëzimi i konsiderueshëm i lëndës së parë dhe prodhimi i mbetjeve në shkallë industriale.
- Ndikime të transportit.

Secila prej këtyre çështjeve potenciale trajtohet në seksionet e mëposhtme.

Efektet në Cilësinë e Ajrit Përreth

Është kryer një studim i detajuar mbi clirimet e gazeve atmosferike nga proceset e përpunimit të cimentos në zhvillimin e propozuar. Ky studim trajtoi clirimet në ajër që mund të ndodhin gjatë fazës normale operacionale të furrës së pjekjes së klinkerit, si dhe clirime në nivele më të ulëta të grimcave të imëta nga oxhakët e përpunimit. Qëllimi i studimit ishte vlerësimi i efekteve të këtyre clirimeve lidhur me përqëndrimet e elementëve ndotës në nivelin bazë. Këto ndryshime në cilësinë e ajrit përreth u krahasuan me kriteret e cilësisë së ajrit sipas udhëzimeve të Bashkimit Evropian (BE) si atyre ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSh).

Clirimet në atmosferë u modeluan sipas versionit më të fundit të modelit të shpërhapjes atmosferike AERMOD, nxjerrë nga Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të SHBA. Ky model mbi shpërhapjen atmosferike është i njohur botërisht dhe përdoret gjerësisht në rregulloret e zhvillimeve industriale. Ky model përdori të dhënat meteorologjike të katër viteve nga një vendodhje tipike përfaqësuese. Modeli AERMOD merr në konsideratë ndikimin e ndërtesave të mëdha dhe terrenin lokal për shpërndarjen e clirimeve atmosferike. Tipari i dytë i modelit është me rëndësi të vecantë pasi vendodhja e propozuar e zhvillimit është në pllajën mbi qytezën e Burizanës, jo larg nga një kreshtë mali e ngritur nga toka e që formon një pjesë të rrëzës së malit në brendësi të zonës malore të rajonit.

Vlerësimi u përqëndrua në zonën e vendbanimeve (receptorë të ndjeshëm) ku individët mund të ekspozohen për periudha të ndryshme kohore sipas kriterëve të cilësisë së ajrit. Zona përreth është modeluar për të gjeneruar rezultate grafike të cilat tregojnë efektet maksimale për shkak të fabrikës. Këto përqëndrime maksimale ndodhin në zonat e pabanuara në territore më të ngritura nga toka.

Vlerësimi rezultoi në përfundimin se në të gjithë receptorët e ndjeshëm, ndryshimet maksimale në dioksidin e squfurit, oksidin e karbonit, grimcat e imëta dhe përqëndrimet mesatare vjetore të dioksidit të azotit si pasojë e funksionimit të fabrikës përbejnë një pjesë të vogël të kriterëve të cilësisë së ajrit dhe se cilësia e ajrit në të ardhmen do të mbetet brenda këtyre kriterëve. Shkarkimet kryesore nga furra e pjekjes janë oksidet e azotit, të cilat cojnë në rritjen me një përqindje të vogël të përqëndrimit të dioksidit të azotit (ndotës sekondar) krahasuar me vlerat kufizuese në orë sipas udhëzimeve të BE-së në receptorët më të ndjeshëm. Sidoqoftë, në Picrragë (Popaij), fabrika do të mund të kontribuojë deri në

25% dhe në Krujë (Pengile) në rreth 15% të kriterit. Cilësia shumë e mirë e ajrit në këto vendodhje rurale, do të mbetet e mirë dhe do të jetë brenda vlerave kufizuese në orë.

Studimi mbi modelin e shpërhapjes dëshmon se në fazën operacionale të fabrikës, cilësia e ajrit do të jetë brenda niveleve të përcaktuara nga BE dhe udhëzimet e OBSH të cilat specifikojnë mbrojtjen e shëndetit publik. Këto vlera kufizuese do të jenë nën nivelin e vlerës që mund të shkaktojë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut apo sistemin respirator duke mbrojtur individët vulnerabël në popullsinë vendore. Mbi këtë bazë, studimi nxjerr përfundimin se nuk do të ketë efekte të pafavorshme në shëndetin publik të popullsinë vendore për shkak të veprimtarisë së fabrikës së cimentos.

Janë kryer gjithashtu edhe vlerësime lidhur me nivelin e ndikimeve potenciale të përhapjes së pluhurave nga territoret e karierave dhe potencialit për ndotje nga fluksi i trafikut gjatë fazës operacionale të zhvillimit industrial. Të dy këto vlerësime dëshmojnë se nuk do të ketë efekte të konsiderueshme mbi cilësinë e ajrit si rezultat i përhapjes së pluhurave nga karierat apo si rezultat i klirimit të gazeve nga automjetet.

Clirimi i Gazeve Atmosferike

Është kryer një vlerësim i clirimeve të mundshme të gazit atmosferik nga fabrika e propozuar. Vlerësimi u përqëndrua në clirimin e gazit kryesor, i cili është dioksidi i karbonit. Nuk ka të ngjarë të clirohen gaze të tjera përveç tij si rezultat i veprimtarisë së fabrikës. Sic ndodh me të gjitha proceset e përpunimit të cimentos, sasi të mëdha të dioksidit të karbonit clirohen si pasojë e reaksioneve kimike që ndodhin gjatë përpunimit të klinkerit të cimentos. Krahas saj, djegia e sasive të mëdha të lëndës djegëse në trajtë të ngurtë con në krijimin e sasive të mëdha të dioksidit të karbonit. Së fundi, energjia përdoret për të nxitur proceset e tjera ndihmëse që lidhen me përpunimin e cimentos. Energjia shpërndahet si rryme elektrike dhe ashtu sic ndodh në këtë rast, sigurohet shpesh nga burime të jashtme e nuk prodhohet në vend. Pjesa më e madhe e rrymës elektrike në Shqipëri sigurohet nga burimet hidrike. Prodhimi i rrymës nga stacione hidro-elektrike nuk përmban prodhimin e dioksidit të karbonit. Për këtë arsye është ndërmarrë një vlerësim mbi gazet atmosferike. Sidoqoftë, për shkak të problemeve që ka Shqipëria lidhur me prodhimin e rrymës elektrike në vend, ka të ngjarë që në një periudhë afatshkurtër deri afatmesme, pjesa më e madhe e rrymës elektrike të importohet nga vendet përreth. Besohet se vendet përreth e prodhojnë rrymën elektrike nëpërmjet djegies së lëndës djegëse në trajtë të ngurtë, e vecanërisht djegies së qymyrgurit.

Vlerësimi dëshmoi se teknologjia e propozuar minimizon shkarkimin e CO₂ dhe ndjek udhëzimet për teknikat më të mira disponueshme për përpunimin e cimentos. Meqenëse cemento do të prodhohet në vend dhe do të përdoret për zhvillimin e infrastrukturës brenda vendit, kjo do të cojë në uljen e nivelit të gazeve atmosferike që prodhohen për të transportuar cimenton në vend.

Për të siguruar se procesi i prodhimit të cimentos është eficient në energji, operatori do të kërkohej të kryejë një vërtetim të detajuar të energjisë 2 vjet pasi fabrika të jetë në funksionim. Qëllimi i këtij vlerësimi do të sigurojë se fabrika funksionon në mënyrën më eficiente të mundshme duke identifikuar nëse është e mundur të merren masa si përqëndrimi i nxehtësisë së mbetjeve industriale për prodhimin e energjisë apo përdorime të tjera për të ulur shkarkimet e dioksidit të karbonit gjatë fazës operacionale. Kjo kërkesë është shkruar në Planin e Monitorimit Mjedisor e Social gjatë Fazës Operacionale. Për më tepër, gjatë fazës operacionale, Antea do të rishikojë kushtet e tregut për të identifikuar nëse teknologjitë e kursimit të energjisë do të mund të instaloheshin në vend, vecanërisht me qëllim instalimin e pajisjeve për shfrytëzimin e energjisë ciluar nga trajtimit i mbetjeve për prodhim energjie në të ardhmen.

Efekte të Tjera Operacionale

Zhurma

Në kohën kur u krye ky vlerësim, nuk ka pasur të dhëna mbi matjen e zhurmës mjedisore për zonën përreth; por ka pasur informacion të kufizuar mbi nivelin e zhurmës nga aktivitetet e funksionimit të fabrikës, shfrytëzimit të karierave dhe trafikut.

Si bazë për vlerësimin e ndikimit janë marrë të dhënat mbi trafikun me të cilat llogariten nivelet e zhurmës së mjedisit në receptorët e ndjeshëm ndaj zhurmës dhe nivelet e zhurmës në burim për një fabrikë të ngjashme në Greqi. Duke përdorur këtë metodë, mund të llogaritet se niveli i zhurmës, prodhuar nga fabrika e prodhimit të cimentos, nuk ka të ngjarë të shkaktojë shqetësime në qendrat e banimit përreth gjatë mbrëmjes apo natës. Mund të ketë shqetësime gjatë ditës në qendrat e banimit pranë karierave. Shqetësimet mund të jenë më të mëdha gjatë procesit të shfrytëzimit të karierave pranë qendrave të banimit dhe para se intensiteti i shfrytëzimit të karierës të përcojë zhurmën e natyrshme në këto komunitete.

Gjatë periudhës operacionale të fabrikës, ndryshimet në fluksin e trafikut në rrjetin rrugor lokal nuk do ta rrisin ndjeshëm nivelin e zhurmës. Sidoqoftë, pronat pranë rrugëve të reja lidhëse mund të ndikohen nga rritja e zhurmës si pasojë e trafikut që kalon nëpër këto rrugë.

Vibrimi nuk ka të ngjarë të jetë i ndjeshëm nga ndonjë aspekt i projektit. Kompania do t'i nënshtrohet zbatimit të praktikave të manaxhimit të zhurmës në të gjitha aspektet e projektimit dhe veprimtarisë së fabrikës së cimentos, shfrytëzimit të karierës dhe transportit.

Një fushë kyçe e përhapjes së mundshme të zhurmës dhe vibrimit është aktiviteti i shpërthimit lidhur me shfrytëzimin e karierës me gur gëlqeror. Vini re se nuk do të ketë aktivitete shpërthyes në karierat e flishit. Për të ulur ndikimin e aktiviteteve shpërthyes në karierën e gurit gëlqeror, operatori do të përdorë teknika të njohura ndërkombëtare të shpërthimeve të *njëpasnjëshme* me qëllim minimizimin e valëve të shpërthimit duke ulur cdo

lloj ndikimi të shpërthimit. Për më tepër, aktivitetet shpërthyes do të jenë të kufizuara gjatë ditës.

Ndikimet Peizazhore dhe Vizuale

Ndikimet peizazhore dhe vizuale janë:

- (i) Ndryshimi i sipërfaqes/mbulesës, përdorimit dhe karakterit të tokës, përfshirë rritjen e intensitetit të aktiviteteve
- (ii) Ndikim vizual lidhur me ndricimin gjatë natës, përfshirë lëvizjen e automjeteve gjatë natës dhe sigurimin e shërbimeve publike.
- (iii) Ndikim vizual i lëvizjeve të automjeteve dhe trafikut në, për në dhe nga zona e fabrikës

Ekologjia

Për të ulur ndikimet në përbërjen ekologjike vendore, si rezultat i rritjes së ndërhyrjes, crregullimit dhe shfrytëzimit nga njeriu, rekomandohet një program edukativ për informimin e punonjësve dhe familjeve të tyre mbi kërkesat ligjore dhe përgjegjësitë ndaj kafshëve të egra. Kjo duhet kryer me anë të metodave me pjesëmarrje meqenëse një pjesë e popullsisë mund të jetë e mirëinformuar për burimet natyrore të ripërtëritshme e mund të shërbejë si një burim i vlefshëm i njohurie. Programi edukativ mbi mjedisin mund të kryhet / lehtësohet në terren nga një ekolog dhe/ose ekspert i hortikulturës.

Toka, Ujrat Sipërfaqësorë dhe Tokësorë

Funksionimi i fabrikës do të përfshijë disa masa për parandalimin e shkarkimeve në tokë, ujra sipërfaqësorë dhe tokësorë. Mementalisht, ka të dhëna se këto shkarkime do të jenë në përputhje me natyrën dhe shkallën e një zhvillimi të tillë dhe se nuk do të ketë ndikime të konsiderueshme. Antea ka qëllim të nxjerrë ujin nga pusët e rezervave ujore e ta përdorë atë për aktivitete industriale. Informacioni në dispozicion dëshmon se shkalla e shfrytëzimit të rezervave ujore tokësore për furnizim me ujë dhe ujitje i tejkalon kërkesat për ujë që nevojiten për prodhimin e cimentos.

Përdorimi i Lëndës së Parë dhe Manaxhimi i Mbetjeve

Pjesa më e madhe e lëndës së parë që nevojitet për procesin e prodhimit do të nxirret nga karierat e gurit gëlqeror dhe flishit. Informacioni i disponueshëm dëshmon se kompania ka studiuar tërësisht natyrën e rezervave të lëndës së parë e ka vërtetuar se nuk do të ketë probleme lidhur me përdorimin e lëndëve të papërshtatshme që shpien në shkarkime të

konsiderueshme në ajër nga procesi. Më pas, në linjën e prodhimit, do të merren masa që të mos lejohet hyrja e materialeve të papërshtatshme për procesin. Prosesi prodhon shumë pak mbetje e ajo mbetje që prodhohet do të reciklohet e do të kthehet përsëri në proces.

Mbetjet, prodhuar nga veprimtaria njerëzore, do të përpunohen duke shfrytëzuar një impiant për përpunimin e mbetjeve, me vendodhje të përhershme në zonë, e cila do të jetë funksionale para arritjes së fazës kulmore të veprimtarive ndërtimore. Impianti i përpunimit do të projektohet për të përballuar kapacitetin e prodhimit gjatë numrit maksimal të personave në terren. Detajet e projektimit të këtij impianti janë diskutuar gjatë momentit të përgatitjes së këtij raporti dhe do të jenë në përputhje me standardin GB8978-1996. Rishikimi i informacionit të disponueshëm të përpunimit të mbetjeve dëshmon se projektimi përputhet me kapacitetin që impianti do të duhet të përballojë. Si pjesë e programit të manaxhimit, operatori kërkohet të dorëzojë projektimin përfundimtar, vendodhjen e shkarkimit dhe ndikimet e mundshme të shkarkimit, në se ka të tilla.

Transporti

Aktualisht, hyrja në zonën e fabrikës kryhet nëpërmjet një rruge që kalon nëpër fshatin Burizanë. Ky është një segment i vështirë rrugor, vecanërisht për automjetet e rënda, si nga pikëpamja gjeometrike ashtu edhe nga ajo e sigurisë rrugore. Një segment i ri rrugor do të ndërtohet që të lidhë fabrikën direkt me autostradën Shkodër – Fushë Krujë duke shmangur zonat urbane të Burizanës dhe Mamurrasit. Segmenti i ri do t'i shërbente fabrikës në mënyrë të drejtpërdrejtë duke shmangur cdo lloj ndërryjeje të trafikut lokal të fshatit.

Një tjetër hyrje në zonën midis karierës së flishit dhe asaj të gurit gëlqeror ofrohet nëpërmjet një rruge që fillon në fshatin e Mamurrasit e kalon përgjatë bregut verior të lumit Droje. Më parë, të dy brigjet e lumit lidheshin nëpërmjet një ure, pikerisht në atë pikë.

Parashikohet që trafiku që do të krijohet në fazën e ndërtimit nuk do të ketë ndikime të konsiderueshme në fluksin aktual të trafikut që përdor arteriet kryesore rrugore; efekti kryesor do të jetë ndikimi në trafikun që përshkon rrugët lokale. Sidoqoftë, niveli i crregullimit të trafikut nuk parashikohet të jetë i lartë. Gjithashtu, vlen të vërehet se transporti i pjesës më të madhe të ngarkesave që lidhen me punët e tokës nuk do të dalë nga fabrika, pasi lënda e gërmuar do të ruhet brenda kufijve të zonës së ndërtimit.

Lënda e parë me gur gëlqeror dhe flish do të transportohet në fabrikën e cimentos në rrugët e reja midis dy karierave dhe fabrikës. Ngarkesat e gurit gëlqeror do të transportohen me kamionë 90 tonësh. Parashikohet që ngarkesa me gur gëlqeror të jetë 40 kamionë në ditë. Meqenëse rruga nga kariera gurit gëlqeror është larg nga zonat e banuara, nuk parashikohet të ketë cilirime nga këto automjete. Ngarkesat e flishit do të transportohen me kamione 22.5 tonësh, përafërsisht 50 ngarkesa në ditë.

Një kapacitet prodhimi prej 4,000 ton në ditë kërkon 200 lëvizje të kamionave 20 tonëshe. Cdo ditë fabrika do të furnizohet me lëndën e parë, e cila parashikohet të kapë shifrën 2,300 ton në ditë – e barazvelfshme me pothuajse 120 lëvizje kamionash në harkun ditor.

Në total, do të nevojiten 320 lëvizje kamionash në ditë për t'i shërbyer më së miri fabrikës në periudhën e prodhimit me kapacitet maksimal. Kjo shifër shumëzohet me 1.3 për të parashikuar rritjen e kapacitetit prodhues në të ardhmen dhe për të mbuluar periudhën e pikut të prodhimit. Shifra e përfutur arrin në 420 lëvizje ditore ose një fluks prej 35 lëvizjesh në orë (bazuar në një periudhë prej 12 orësh). Shifra e mësipërme shpërbëhet më tej në një lëvizje kamioni cdo 2 minuta në secilin drejtim. Si përfundim, kërkesa për trafikun maksimal për në dhe nga fabrika parashikohet të arrijë në 120 automjete private dhe 40 mjete të rënda transporti (autobusë dhe kamionë) për orën e pikut në një drejtim të vetëm. Cështjet e sigurisë ndaj komuniteteve vendore, që lidhen me zhvillimin e rrugëve, është vlerësuar si pjesë e Studimit mbi Sigurinë e Transportit, rezultatet e së cilës diskutohen në “Cështjet Sociale dhe Ekonomike”, më poshtë.

Ndikimet në infrastrukturën portuale do të jenë ekskluzivisht në gjysmën e skelës lindore të Durrësit që do të shfrytëzohet për nevojat e fabrikës. Gjysma tjetër do të shfrytëzohet – sipas prioriteteve – për ¼ e vitit. Si rezultat porti do të nxjerrë përfitime të mëdha si dhe përmirësim e modernizim të infrastrukturës së tij.

Ndikimet gjatë Fazës së Demolimit

Deri tani nuk është kryer asnjë ndikim i detajuar mjedisor që lidhet me fazën e demolimit. Fabrika parashikohet të ketë një jetëgjatësi prej 50 vjetësh, ndaj momentalisht mund të përcaktohen vetëm parimet e përgjithshme.

Në kushte të përgjithshme, procesi i nxjerrjes jashtë përdorimi ka të ngjarë të nxisë ndikime të ngjashme me ato që përjetohen gjatë fazës së ndërtimit. Metodave dhe teknikat e përzgjedhura parashikohen të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare që do të mbizotërojnë gjatë kohës së nxjerrjes jashtë përdorimit. Proces i demolimit kërkon:

- Heqja e të gjitha pajisjeve dhe impianteve sipërfaqësore;
- Heqja e strukturave të qëndrueshme dhe mbulesave të sipërfaqes;
- Braktisja e shërbimeve komunale në shtresat nën-sipërfaqësore ose mbushja dhe braktisja, si të jetë e përshtatshme;
- Rikthim i terrenit dhe zonës së shfrytëzuar nga projekti në kushtet e para-ndërtimit. Lidhur me rehabilitimin e karierave gjatë fazës operacionale, punimet do të jenë të vazhdueshme në përputhje me programin e punës së miratuar gjatë propozimeve të planifikimit me autoritetet shqiptare.

Për fabrikën e cimentos, Antea do të zhvillojë një plan të mbylljes së kantierit gjatë fazave të mëvonshme të projektimit dhe do të mirëmbajë planin gjatë gjithë jetëgjatësisë së zhvillimit industrial. Plani duhet të përfshijë metodën e demolimit të fabrikës në mënyrë të tillë që të shmangë cdo lloj ndotje dhe ta kthejë terrenin në gjendje të pranueshme. Përveç kësaj, plani i demolimit duhet të marrë në konsideratë ndikimet sociale dhe ekonomike dhe të përfshijë masa zbutëse, aty ku shihet e nevojshme.

Si pjesë e planit të mbylljes së kantierit duhet të shqyrtohen mundësitë që ofron zona për qëllime afatgjata të mbrojtjes së biodiversitetit. Jashtë zonave kryesore të zhvillimit nuk janë identifikuar zona me rëndësi ekologjike që do të mund të ndikojnë në veprimtaritë e demolimit, ndonëse do të duhet t'i kushtohet vëmendje shfrytëzimit afatgjatë të rrugëve hyrëse në të dy karierat. Kjo do të jetë në varësi të nivelit të ardhshëm të shfrytëzimit të tyre. Mund të dalë e nevojshme heqja e rrugëve dhe 'rikthimi në formën e mëparshme' të tokës dhe bimësisë por është e mundshme edhe kufizimi i hyrjes në zonë vetëm me automjete apo vetëm në këmbë.

Plani i mbylljes së fabrikës dhe planet paraprake të rehabilitimit kanë nevojë të rishikohen dhe përditësohen nga pikëpamja e përvojës për zbatimin e masave ekologjike zbutëse dhe kompensuese – vecanërisht propozimet e "Rehabilitimit të Habitatit". Këto veprimtari rehabilituese të habitatit kanë nevojë të monitorohen gjatë jetëgjatësisë së projektit, në mënyrë që të mund të nxirren mësimet dhe të aplikohen para dhe në fazën përfundimtare të mbylljes së kantierit.

Përgjithësisht, aktivitetet e demolimit janë kalimtare, ndaj kanë të ngjarë të kenë shkallën e ndikimeve të fazës ndërtimore.

Cështjet Sociale dhe Ekonomike

Ndikimet themelore të zhvillimit të propozuar lidhen me katër aspekte kryesore, të cilat janë:

- Punësimi i fuqisë punëtore të ndërtimit dhe funksionimi i kampit të ndërtimit, në vecanti kushtet, marrëdhëniet e punësimit të punëtorëve të huaj dhe kushtet e jetesës.
- Kushtet e jetesës së banorëve të Picrragës dhe Bretit, aktivitetet e të cilëve shtrihen në një pjesë të tokës që do të shfrytëzohet nga fabrika dhe karierat. Disa prej këtyre familjeve konsiderohen vulnerabël;
- Mundësitë për punësim me Antea-n dhe kompanitë furnitore vendore dhe përfitimet e ardhshme në të ardhurat e bashkisë Krujë.
- Rrjeti rrugor dhe transporti.

Punësimi i punëtorëve të huaj në kampin e ndërtimit duhet të përmbushë disa kërkesa që parashikon ligji kombëtar mbi pagat, taksat dhe sigurimet. Punëtorët e huaj do të përfitojnë 30 ditë pushime në vit dhe një biletë avioni të paguar nga kompania. Deri tani nuk jepet asnjë detaj mbi kushtet e jetesës dhe projektimit të kampit, sidoqoftë, VNMS përmban identifikimin e masave zbutëse për dhënien dhe rishikimin e këtij informacioni, si dhe monitorimin e cilësisë së jetës së punëtorëve.

Kontrollet shëndetësore të punëtorëve, përveç ndihmës së parë, do të kryhen nëpërmjet kontratave të shërbimeve me objektet vendore dhe ato të Tiranës. Rastet emergjente do të trajtohen në Tiranë. Shërbimi shëndetësor i rrethit të Krujës, me mbështetjen e Institutit të Shëndetit Publik të Tiranës, do të ofrojë trajnime ndërgjegjësimi për komunitetin që do të jetë më i ndjeshëm ndaj sëmundjeve të transmetueshme. Një forum koordinues do të ngrihet për të vendosur një komunikim të shëndoshë të dyanshëm, duke mundësuar shkëmbimin e informacionit dhe reagimet midis kampit dhe grupeve vendore të interesit.

Një sërë familjesh kanë si mënyrë jetese aktivitetet që shfrytëzojnë një pjesë të tokave që do të përfshihen në terrenin ku do të ngrihet fabrika e cimentos dhe kariera. Aktivitetet e mbledhjes së bimëve aromatike dhe kullotjes ka të ngjarë të jenë aktivitetet që do të pësojnë ndikimin më të madh brenda kufijve të zhvillimit të propozuar. VNMS identifikon gamën e këtyre ndikimeve dhe rekomandon se një specialist i blegtorisë dhe kullotave ka ndërmarrë një vlerësim më të detajuar mbi shfrytëzimin e tokës nga rritësit e bagëtive dhe konfirmimin e ndikimeve në vlerat ushqyese dhe financiare. Lista e plotë e grumbulluesve të bimëve që kanë fituar më shumë se 100,000 lekë në vitin 2006 mund të identifikohet nga të dhënat e shitjeve të bimëve aromatike. Kjo vlerë llogaritet cdo lloj efekti të konsiderueshëm në të ardhurat (dmth mbi 10% të të ardhurave) si rezultat i projektit, duke marrë parasysh familjet vulnerabël dhe ato me të ardhura të pakta.

Njerëzit që ka të ngjarë të preken nga projekti u shprehën se preferojnë të kompensohen për mënyrën e jetesës nëpërmjet punësimit në fabrikën e re të cimentos. VNMS identifikon familjet vulnerabël, aktivitetet e cilësia e jetës së të cilëve do të ndikohen. Antea po harton një plan kompensimi mbi bazën e rezultateve të VNMS dhe vlerësimeve të tjera të mëtejshme. Plani dhe kriteret për përshtatshërinë do të bëhen të njohura nga informacioni bazë i VNMS-se. Gjatë hartimit të këtij plani, të gjithë Njerëzit e Ndikuar nga Projekti do të ftohen të regjistrohen gjatë një periudhe 3-mujore planifikimi dhe cdo rast do të rmerret në shqyrtim. Njerëzit e ndikuar nga projekti kanë shprehur një preferencë të fortë për kompensim për menyrën e jetesës në formën e punësimit në fabrikën e re të cimentos. Kjo do të shqyrtohet në vlerësimet e rasteve studimore. Një dokument kuadër i kompensimit shoqëron VNMS-në dhe parashtron parimet që do të udhëheqin planin përfundimtar.

Përfitim i madh nga projekti do të jetë rritja e të ardhurave në buxhetin e bashkisë Krujë dhe rritja e punësimit në zonë. Buxheti aktual i bashkisë Krujë është rreth 100 milion lekë ose € 0.813 milion. Taksa e biznesit vendor mbështetet në sipërfaqen e tokës së zënë. Pritet që të ardhurat nga taksa e re për prodhimin e cimentos dhe shfrytëzimin e karierave të gjenerojnë

një shtesë të ardhurash prej 60 milion lekë/vit ose € 0.49 milion/vit për buxhetin e bashkisë së Krujës.

Një total prej 400 vendesh pune parashikohet të gjenerohet në fazën e funksionimit të fabrikës dhe shfrytëzimit të karierave. Prej këtyre 43% (përfshirë 70 vende pune për shoferët e automjeteve të tonazhit të rëndë) parashikohen të punësohen me kontrata pune dhe 57% të punësohen drejtpërsëdrejti. Nga 400 vendet e punës, rreth 42% mund të përkohet me nevojat e popullsisë vendase. Rreth 60% e punës kërkon organizimin e punës me turne. 12% e pozicioneve parashikohen të mbulohen nga gratë. Rreth 95% e tyre parashikohen të mbulohen nga stafi shqiptar dhe, fillimisht, të paktën 5% të mbulohen nga shtetas të huaj. Parashikohet që ky sistem të nxisë ripërsëritjen e kontratave apo punësimin e përhershëm.

Rruga e re që do të ndërtohet midis fabrikës së cimentos dhe autostradës Tiranë – Shkodër parashikohet të gjenerojë një numër të madh ndikimesh. Sic diskutohet në VNMS, do të blihet një pjesë e vogël e tokës private e pronarët do të kompensohen sipas një mekanizmi të posacëm. Parashikohet që rruga do të përmirësojë rrjetin e telekomunikacionit dhe tregtinë. Gjykohet se ky përmirësim do të reflektohet në vlera të larta të tokës, vecanërisht në rastet kur tokat janë pranë rrugës.

Ka përfunduar së kryeri një vlerësim i riskut në itinerarin e rrugës, i cili ka identifikuar cdo lloj shqetësimi apo çështje të shëndetit apo sigurisë nga grupet e interesit. Studimi u krye nga ekipi i punës së Atkins mbi Autostradat dhe Transportin në Athinë, Greqi. Ai përmbledh një vlerësim të sigurisë së rrugëve të propozuara midis Vendodhjes së Fabrikës së Cimentos Titan dhe Rrugës Nacionale Fushë Krujë – Lezhë (RrN - VF) dhe midis Karierës së Flishit dhe Vendodhjes së Fabrikës së Cimentos (KF – VF). Vlerësimi u krye nga ANTEA CEMENT S.A. dhe BERZH-KFN, në nëntor 2007, në përputhje me Metodologjinë për Vlerësimin mbi Sigurinë Rrugore. Vlerësimi ndoqi standardet e miratuara nga Agjencia e Autostradave dhe Departamenti i Transportit të Britanisë së Madhe. Raporti identifikoi çështjet me shkallë të lartë rreziku hasur në projektimin fillestar; ndaj, u shfrytëzua për të siguruar masa të mëtejshme sigurie në proceset e projektimit të rrugëve. Çështjet me shkallë të lartë rreziku dhe masat përkatëse zbutëse mund të përmbliken si më poshtë:

- Hapja e rrugëve në terrene kodrinore të thikëta do të shkaktojë mungesë qëndrueshmërie: I shtohen projektim masat mbrojtëse si psh rrjetat prej teli për të siguruar që rrëshqitja e gurëve apo tokës nuk do të shkaktojë aksidente.
- Projektimi fillestar nuk deshmoi për kushte lehtësuese për këmbësorët në vendkalime apo kalime për kembësorët. Ato do të përfshihen në projekte në vendodhjet ku mund të shfaqen probleme. Zonat në të cilat mund të shfaqen këto probleme janë identifikuar udhëkryqet, zonat me shume hyrje / dalje sic janë zona e varrezave dhe pelegrinazhit dhe ura që shtrihet përgjatë rrugës që shpie në Karierën e Flishit.

- Ndricimi i papërfshirë në projektimin fillestar mund të conte në aksidente, vecanërisht në udhëkryqe. Ndaj, ndricimi propozohet vecanërisht në udhëkryqe.
- Mungesa e hyrjes së planifikuar në zonën e varrezave dhe pelegrinazhit. Projektimi i rishikuar do të përfshijë përmirësim të kushteve hyrëse në të dy zonat dhe parkimin në zonën e pelegrinazhit. Për më tepër do të ndërmerren masa për manaxhimin e qarkullimit të bicikletave dhe mjeteve që tërhiqen nga kafshët. Rreziku për aksidentet do të zvogëlohet nga zbatimi i programeve edukative (fushatë ndërgjegjësimi për sigurinë rrugore) dhe koordinimit me komunitetet vendore si dhe programe të trajnimit të drejtuesve të automjeteve dhe zbatimit të procedurave të raportimit të goditjeve / aksidenteve. Si pjesë e këtij ushtrimi, propozohet rishikimi i kontratave dhe kushteve të qeradhënies së mjeteve për transport të vecantë. Komuna do të vendosë për nevojën e nxjerrjes së urdhëresave apo rregulloreve të sigurisë për veprimtaritë e bizneseve lokale pranë rrugëve.

Përmbledhje e Ndikimeve

Në formë të përmbledhur, efektet kryesore potenciale mjedisore që rezultojnë nga zhvillimi ka të ngjarë të shoqërohen me aspektet e mëposhtme:

- Humbja e vendbanimeve vendore. Ekziston mundësia që me anë të manaxhimit të duhur të zonës përreth të arrihet përmirësimi i kushteve ekologjike lokale.
- Ndikimi vizual i ndërtimit dhe funksionimit të fabrikës së cimentos dhe karierave vendore.
- Ndikimi i zhurmave lokale do të mbizotërojë vecanërisht gjatë fazës së ndërtimit. Ndikimi i zhurmës nga fabrika gjatë fazës operationale është pothuajse e papërfillshme. Ndikimet e zhurmave nga karierat, vecanërisht shpërthimet në karrierën e gurit gëlqeror mund të jenë të konsiderueshme por nuk ka të ngjarë të kthehen në shqetësim. Rritja e transportit mund të sjellë ndikime në disa zona rurale përgjatë itinerarit të rrugës së re automobilistike, por nuk ka të ngjarë të jenë të konsiderueshme në autostradat kryesore.
- Cilirimet në ajër duke respektuar vlerat kufizuese lokale dhe ndërkombëtare
- Shkarkimet në tokë, ujrat sipërfaqësore dhe tokësore. Zhvillimi nuk do të krijojë një rutinë të shkarkimit të lëndëve; sidoqoftë, shkarkimet në tokë, ujrat sipërfaqësore dhe tokësore mund të ngjasin në mungesë të kontrollit të duhur gjatë të gjitha fazave të zhvillimit (faza ndërtimore, operationale, demoluese).

- Parashikohet që trafiku që do të krijohet në fazën e ndërtimit nuk do të ketë ndikime të konsiderueshme në fluksin aktual të trafikut që përshkon arteriet kryesore rrugore; efekti kryesor do të jetë ndikimi në trafikun që përshkon rrugët lokale. Sidoqoftë, niveli i crregullimit të trafikut nuk parashikohet të jetë i lartë. Gjithashtu, vlen të vërehet se transporti i pjesës më të madhe të ngarkesave që lidhen me punët e tokës nuk do të dalë nga fabrika, pasi lënda e gërmuar do të ruhet brenda kufijve të zonës së ndërtimit.
- Ndikime pozitive dhe negative social-ekonomike në territorin lokal dhe atë rajonal.

Tabelat e mëposhtme paraqesin një përmbledhje të këtyre ndikimeve, masave zbutëse dhe planet e monitorimit të mjedisit.

Përmbledhje Ndikimeve të Fazës Ndërtimore dhe Masat Zbutëse të Propozuara

AJRI			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Cilësia e Ajrit – përhapja e pluhurit gjatë fazës ndërtimore dhe punëve të tokës	Zhvillimi i procedurave për: - spërkatja me ujë e rrugëve dhe pargjeve të materialeve - mbulimi i automjeteve që transportojnë ngarkesa materiale për të parandaluar përhapjen e pluhurave nga automjetet - kufizimet e shpejtësisë në sipërfaqet e pashtruara në zonë për të kufizuar ngritjen e pluhurit	Përhapja e pluhurit do të jetë e përqëndruar në zonën e ndërtimit dhe nuk do të ndikojë komunitetin vendor. Sidoqoftë, punëtorët duhet të pajisen me maska kudër pluhurit, vecanërisht në ditë të thata.	Ndikim negativ i vogël

TOKA DHE UJI			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Importimi i ndotësve si pjesë e lëndëve që do të përdoren gjatë procesit të mbushjes dhe nivelimit të tokës	Sigurimi se ndotësit nuk janë të pranishëm në materialet e importuara në zonë duke zgjedhur burimin e duhur të materialeve dhe duke bërë analizat kimike, në se do të jetë e nevojshme	Potenciali për importin e ndotësve në material do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Shkarkimi/clirimi aksidental gjatë transportit të lëndëve djegëse, vajore, kimike, lëndëve të rrezikshme, etj në tokë, vecanërisht	Vendosja e procedurave dhe protokolleve të duhura si dhe monitorimi i transportit dhe trajtimit të materialeve	Potenciali për shkarkimet/clirimet aksidentale gjatë transportit të materialeve në zonë do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

TOKA DHE UJI			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
në zonën e ndërtimit			
Shkarkimi/clirimi aksidental i lëndëve djegëse, vajore, lkimike, lëndëve të rrezikshme, etj në tokë, vecanërisht në zonën e ndërtimit, gjatë magazinimit	Të gjitha zonat e magazinimit do të kenë masat e duhura të sigurisë mjedisore për të parandaluar shkarkime aksidentale në tokë	Potenciali për shkarkimet aksidentale të materialeve gjatë fazës së magazinimit në zonë do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Shkarkimi/clirimi aksidental i lëndëve djegëse, vajore, kimike, lëndëve të rrezikshme, etj në tokë, vecanërisht në zonën e ndërtimit, gjatë transportit për në vendin e përdorimit	Vendosja e procedurave dhe protokolleve të duhura si dhe monitorimi i transportit dhe trajtimit të materialeve për sa kohë janë në zonën e zhvillimit	Potenciali për shkarkimet aksidentale të materialeve gjatë transportit dhe trajtimit të lëndëve brenda zonës së zhvillimit do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Shkarkimi/clirimi aksidental i lëndëve djegëse, vajore, kimike, lëndëve të rrezikshme, etj në tokë, gjatë përdorimit psh rimbushja me lëndë djegëse, mirëmbajtja, etj.	Vendosja e procedurave dhe protokolleve të duhura si dhe monitorimi i trajtimit e përdorimit të materialeve. Aty ku është e mundur, zonat ku bëhet rimbushja me lëndë djegëse dhe zonat e mirëmbajtjes do t'i nënshtrohen një kontrolli të posaçëm	Potenciali për shkarkimet aksidentale të materialeve gjatë përdorimit do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Derdhjet aksidentale të mbetjeve të lëngshme gjatë largimit nga zona	Vendosja e procedurave dhe protokolleve të duhura dhe monitorimi i largimit të mbetjeve nga zona	Potenciali për shkarkimet aksidentale të mbetjeve gjatë largimit nga zona do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Shkarkim aksidental i ujërave të zeza në tokë dhe rezervat ujore tokësore nga kampi i punëtorëve	Ujrat e zeza nuk do të shkarkohen në tokë	Asnjë	Ndikim i papërfillshëm / Zero
Ndotja e kanaleve të lundrueshme nga shkarkimi i mbetjeve të	Sigurimi se fabrika ndjek standardet dhe udhëzimet vendore dhe ndërkombëtare.	Potenciali për shkarkimin e dëmshëm të mbetjeve të lëngshme në se objekti nuk	Ndikim negativ i vogël

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

TOKA DHE UJI			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
lëngshme nga fabrika e propozuar	Mbetja e fazës përfundimtare nuk do të ketë ndikim të thellë negativ në rezervat ujore. Fabrika do të jetë e projektuar në mënyrë të tillë që të përballojë kapacitetin e të gjithë kampit të ndërtimit.	parashikon hollësisht apo nuk është manaxhuar mirë.	
Shkarkimi i ndotësve në tokë nëpërmjet ujit që përdoret për veprimtarinë e fabrikës, pajisjeve dhe larjes së makinave	Aktivitetet larëse do të zhvillohen në zona me kontroll të procedurave të përshtatshme dhe do të monitorohen për të siguruar se masat parandaluese janë efektive.	Potenciali për shkarkimin aksidental të ndotësve në tokë gjatë aktiviteteve larëse do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Rritja e përmbajtjes sedimentare të ujit në receptorët ujorë natyrorë si rezultat i derdhjes së drejtpërdrejtë të lëndëve	Minimizimi i gërmimeve gjatë fazës ndërtimore Hullitë e përkohëshme të sistemit të kullimit dhe pellgjet e sedimentimit për mbledhjen e rrjedhjeve sipërfaqësore	Asnjë	Ndikim i papërfillshëm
Ndotja e receptorë ujorë natyrorë si rezultat i derdhjes së ujrave të zeza të papërmuara	Ndërtimi i një sistemi të kanalizimeve dhe një impianti për trajtimin e ujrave të zeza.	Asnjë	Ndikim i papërfillshëm
Ndotja e ujrave tokësorë si pasojë e rrjedhjes së substancave ndotëse	Përdorimi i materialeve ndërtimore që nuk përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin Magazinimi i materialeve të mundshme ndotëse në zonat të përshtatshme e mbajtja e tyre nën kontroll. Cdo pjesë toke e ndotur gjatë fazës ndërtimore do të hiqet e do të	Asnjë	Ndikim i papërfillshëm

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

TOKA DHE UJI			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	depozitohet në zonat e depozitimit të mbetjeve të rrezikshme.		

PËRDORIMI I MATERIALEVE DHE MANAXHIMI I MBETJEVE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Prodhimi i mbetjeve	Ripërdorimi i dheut Ruajtja e mbetjeve dhe procedurat e kontrollit Ndarja dhe reciklimi i mbetjeve	Largimi i mbetjeve nga zona do të kryhet nëpërmjet bashkisë	Ndikim negativ i vogël

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

EKOLOGJIA			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Territori i Burizanes – Terrenet e Fabrikës së Cimentos dhe Karierave			
Humbja e bimësisë gjatë pastrimit të terrenit	Zhvendosja e dheut dhe disa specieve bimëore për të ndihmuar rehabilitimin e zonave të zhveshura përreth. Programi i Rehabilitimit të Habitaveve që përfshin “Vrojtimin e Habitaveve dhe Studimin e Manaxhimit” vecanërisht në zonat fqinje, për t’u përcaktuar, dhe në bashkëpunim të ngushtë me ekologët dhe komunitetet vendore; mbledhja e bimëve; dhe krijimi i një fidanishteje Përfshirja e shumimit të specieve të rrezikuara (Lista e Kuqe Shqiptare) si <i>Quercus ilex</i>, <i>Salvia officinalis</i>. Vrojtimi dhe Metodologjia Ekologjike mbi Ndërtimin e Rrugëve Hyrëse (rekrutim i një ekologi për projektin) Antea Cement do të pyllëzojë 250 ha parcela të degraduara pyjore në ekonominë pyjore Krujë, në zbatim të Ligjit Nr. 9793 datë 23.7.2007 “Për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të parcelave në ekonominë pyjore Krastë-	Humbja e bimësisë nuk mund të shmangët por mund të kompensohet nga rehabilitimi me sukses, përmirësimi dhe manaxhimi afatgjatë i zonave përreth për konservim dhe përdorim produktiv	Ndikim kritik (zona e rezervave të flishit) – Ndikim negativ i moderuar (zona e karierës së gurit gëlqeror) dhe Ndikim i mesëm pozitiv – ndikim i konsiderueshëm (zona fqinje e rehabilituar)

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

EKOLOGJIA			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	Krujë dhe Shënmri-Brret, që do të përdoren për ndërtimin e fabrikës së çimentos e për kariera nga "Antea Cement" sh.a.		
Shfrytëzim i mëtejshëm i tokës (humbja e habitateve) për kampin e përkohshëm të ndërtimit	Ndërtimi i kampit të përkohshëm në truallin që me kalimin e kohës do të shfrytëzohet si rezervë e nxjerrjes së lëndës së parë	Asnjë ndikim shtesë pasi shfrytëzimi i tokës do të ndodhë gjithësesi në terrenin e karierave	Ndikim i papërfillshëm / Zero
Shkatërrimi i faunës dhe habitateve të tyre (gjitarët, shpendët, zvarranikët, amfibët, vertebrorët)	Vrojtim i mëtejshëm i ekologjisë / faunës në stinët e dhura dhe monitorimi i zhvendosjeve nga një specialist i kompanisë	Zhvendosja e faunës në territorin fqinj mund të ndihmojë në mbijetesën afatshkurtër por jo afatmesme të specieve, në se këto territore janë të zëna. Popullimi i territoreve mund të ndodhë në periudha afatgjata.	Ndikim negativ i vogël
Rritja e presionit të shfrytëzimit të territoreve fqinje si habitate të mundshme	Kryerja dhe zbatimi i një "Vrojtimi Habitatesh dhe Studimi të Manaxhimit", në konsultim të ngushtë me komunitetin vendor	Vendosja e një klime bashkëpunuese me komunitetin vendor dhe përdorimi i projektit si një burim alternativ të ardhurash duhet të çojë në përmirësim të habitateve.	Ndikim i mesëm pozitiv – ndikim i konsiderueshëm
Ndikim në përbërjen ekologjike të zonës përreth nga fuqia punëtore e huaj dhe e përkohëshme si rezultat i pastrimit të terrenit nga bimësia (për dru djarri, bime medicinale) dhe zënies së kafshëve të egra	Program edukimi, monitorimi dhe zbatimit. Manaxhimi i mbetjeve dhe impiantet / repartet e përpunimit të tyre.	Zbatimi mund të jetë i vështirë dhe parashikohet ndonjë ndikim	Ndikim i vogël negativ – ndikim i moderuar (në varësi të zbatimit)

NDIKIME PEIZAZHORE & VIZUALE

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Dëmtim i karakterit peizazhor dhe bukurisë pamore për shkak të prezantimit të tipareve dhe veprimtarive që nuk janë në harmoni me peizazhin	Planifikim sensitiv i terrenit të punës dhe tërë kompleksit Mbjelle sipas strukturave të avancuara Minimizimi i ndricimit punimeve gjatë natës	Do të ketë ndryshim të karakterit rural të peizazhit dhe humbjes së bukurisë pamore kryesisht për shkak të aktiviteteve jashtë zonës territorit të zhvillimit	Ndikim i vogël negativ – ndikim i moderuar

ZHURMA DHE VIBRIMI (përfshirë transportin)			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Zhurmë nga ndërtimi i fabrikës / karierave dhe segemteve të reja rrugore	Manaxhimi i mirë i zonës; Zgjedhja e duhur e makinerive; Metodat e punës; Orët e punës; Trajtimi me efikasitet të materialeve.	Pa njohur detajet është e pamundur të parashikohet nëse do të ketë rritje të zhurmave në qendrat e banuara	N/A (e pazbatueshme)
Zhurmë nga trafiku në fazën ndërtimore që vjen nga përdorimi i rrugëve ekzistuese që kalojnë nëpërmjet qendrave të banuara.	Përcaktimi i itinerarit të rrugëve të reja me numrin më të vogël të pronave në afërsi të tyre. Mbajtja në minimum e qarkullimit të makinave. Pas ndërtimit të segmenteve rrugore, i gjithë fluksi i trafikut që lidhet me ndërtimin e zhvillimit do të përshkojë vetëm këto rrugë.	Mund të ketë rritje të zhurmave në vendbanimet në afërsi të itinerarit të zgjedhur si rrugë hyrëse dhe segemteve rrugore, pasi ato të përfundohen.	Ndikim i vogël negativ

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

NDIKIME SOCIALE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Problemet shëndetësore të punëtorëve të huaj mund të ndikojnë në punë dhe pagesë	Specifikim i përfitimeve të arsyeshme lidhur me sëmundjet dhe raportin e paguar	Sëmundja për një periudhë të caktuar do të ndikojë tek fitimet. Kthimi i shpejtë në punë mund të dëmtojë shëndetin.	Ndikim negativ i vogël
Punëtorët – raste emergjente industriale	Për të gjitha rastet emergjente, janë vendosur marrëdhënie kontraktuale me Tiranën për shërbime dhe trajtimime cilësore të rasteve.	Në varësi të rastit.	Ndikim negativ i vogël
Kushtet e jetesës dhe cilësia e jetës së punëtorëve të huaj. Ndikimet e shërbimeve publike dhe komunale në fshatrat përreth.	CBMI do t'i japë Titan-it specifikat e detajuara të skicës së kampit, objekteve që do të ngrihen në të dhe ofrimin e shërbimeve (bashkë me largimin e mbeturinave) në përputhje me standardet e përcaktuara ndërkombëtare. Titan do të monitorojë kushtet e punës si dhe sigurinë e shëndetit; kjo do të kërkojë që në ekipin e punës të ketë një folës të gjuhës kineze.	Në varësi të ndjeshmërisë së individit. Nëse kushtet nuk janë të mira, një sërë çështjesh mund të ngrihen në kamp e më pas do të përhapen në komunitetin vendor.	Ndikim negativ i vogël/ i moderuar
Shqetësimet dhe konfliktet në kamp	Kodet e sjelljes në kamp dhe zbatimi me detyrim i disa çështjeve kyçe të sjelljes dhe përdorim i arsyeshëm i alkoolit.	Nuk është identifikuar asnjë	Ndikim negativ i vogël
Shqetësime dhe / ose konflikte me popullsinë vendore	Kodi i sjelljes në kamp që do të zbatohet nga të tërë punëtorët Ofrimi i punësimit dhe mundësitë e popullsisë vendore për të minimizuar armiqësinë. Komiteti ndërlidhës për identifikimin e	Parashikohet mbetja e disa efekteve por në shkallë të kufizuar, në varësi të kohës së lirë së punëtorëve dhe ndërveprimeve me popullsinë vendore.	Ndikim negativ i vogël / i moderuar

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

NDIKIME SOCIALE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	cështjeve problematike dhe zgjidhjen e tyre.		
Mundësi për prokurime lokale	Titan / Antea do të vendosin kontaktet e para dhe do të nxisë CMB për të maksimizuar blerjet lokale Titan do të ofrojë një lehtësues të trajnuar për të ekzaminuar mundësitë dhe cështjet e biznesit nga këndvështrimi i CMBI dhe bizneseve vendore. Antea do të ofrojë konsulentë në mbështetje të nismave të zhvillimit të biznesit dhe për të siguruar se projektet janë financiarisht të qëndrueshme. Ofrim i mbështetjes nga Titan dhe / ose kushte koncesionare (jo subvencione) nga CMBI për t'i ardhur në ndihmë bizneseve të reja.	Kjo nuk ka të ngjarë të ndodhë deri sa Titan të ofrojë CBMI-së nxitësit financiarë apo kërkesat kontraktuale Marrëdhënie të dobëta me komunitetin në se ata shohin se nuk kanë asnjë përfitim komercial nga kampi	Mund të variojë nga përfitime të papërfillshme deri në mesatare në varësi të përpjekjeve dhe nismave që ofrohen nga të tëra palët.
Potencial për shtimin e rasteve të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SST) në radhët e popullsisë vendore dhe punëtorëve	Fushata ndërgjegjësimi për punëtorët e huaj dhe grupet/vendet tipike urbane të zonës mbi parandalimin e SST. Shpërndarja falas e prezervativëve në farmaci dhe tualete ose në qendra të tjera publike.	Veshtirë të identifikohet shkaku apo burimi i një sëmundje të tillë pasi ajo është sëmundje që mbahet fshehtas e raportohet rrallë. Sidoqoftë, përhapja e disa sëmundjeve mund të kërkojë trajtime mjekësore; në rastin e HIV, ky trajtim do të jetë i gjatë.	Ndikim negativ i moderuar (deri diku kritik)

Shkalla e Vlerësimit të Ndikimit – Përkufizim

Dëm shumë i rëndë

Dëm i rëndë

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Ndikim negativ i moderuar
Dëm i vogël
Dëm i papërfillshëm/ Zero
Përfitim i vogël
Përfitim mesatar
Përfitim i konsiderueshëm

Përmbledhje e Ndikimeve të Fazës Operacionale dhe Masat Zbutëse të Propozuara

CILËSIA E AJRIT			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Clirimi i gazeve të djegies nga oxhaku i furrës.	Teknikat e kontrollit parësor të manaxhimit operacional.	Cilësia e ajrit lokal do të jetë brenda parametrave të BE-së dhe udhëzimeve të OBSH lidhur me mbrojtjen e shëndetit publik në të gjitha vendodhjet përkatëse. Si përfundim mund të thuhet se fabrika e cimentos nuk do të ketë ndikime shëndetësore në popullsinë lokale.	Jo domethënës
Shkarkimi i grimcave nga furra, impianti i ftohjes së klinkerit, impianti i përpunimit të qymyrgurit dhe cimentos.	Filtrat e ajrit – për zbutjen e pluhurit	Cilësia e ajrit lokal në Burizanë nuk do të ndikohet dhe do të jetë brenda parametrave të BE-së dhe udhëzimeve të OBSH lidhur me mbrojtjen e shëndetit publik.	Ndikim i papërfillshëm
Përhapja e pluhurit gjatë shfrytëzimit të karierave.	Përdorimi i teknikave më të mira të manaxhimit gjatë procesit të nxjerrjes së lëndës së parë dhe ngarkimit.	Nuk ka të ngjarë të ketë dëme serioze si pasojë e depozitimit të pluhurave në zonën e qendrave të banimit.	Ndikim i papërfillshëm
Clirimi i gazeve nga djegia e lëndës djegëse gjatë transportit të materialeve për në dhe nga zona.	Përdorimi i automjeteve të reja e efiente, trajnim i shoferëve për uljen e nivelit të clirimeve (psh parandalimi i përdorimit të makinave me xhiro të shpejta, fikja e motorrit kur automjetet nuk janë në përdorim), racionalizimi i sistemit të manaxhimit të trafikut për të optimizuar eficientën e transportit.	Efekte lokale në cilësinë e ajrit në vendet e banuara pranë disa rrugëve por rritje shumë e vogël e kriterëve të cilësisë së ajrit.	Ndikim i papërfillshëm

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

UJRAT SIPËRFAQËSORE DHE TOKËSORE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Shtimi i përmbajtjes sedimentare në ujrat sipërfaqësore si pasojë e përhapjes së pluhurave fluturues.	<u>Për fabrikën e cimentos:</u> Manaxhimi i ujrave të bardha nëpërmjet kanaleve dhe/ose ulluqeve dhe rezervuarëve të trajtimit. <u>Për karierat:</u> Sipërfaqja shfrytëzuese e karierës duhet të jetë minimale. Rehabilitimi gradual i vendodhjeve (nëpërmjet zbukurimit të peizazhit dhe mbjelljes së bimëve) aty ku ka përfunduar procesi i nxjerrjes së lëndës së parë. Manaxhimi i ujrave të bardha nëpërmjet vijave periferike ujore dhe rezervuarëve të trajtimit.	Asnjë	Ndikim i papërfillshëm
Ulja e cilësisë së ujrave sipërfaqësorë si pasojë e derdhjes së ujrave industrialë apo rrjedhjes së lëndëve ndotëse.	<u>Për fabrikën e cimentos:</u> Qarkullimi i ujrave industrialë në qark të mbyllur përfshirë rezervuarët e trajtimit. Ruajtja e lëndës djegëse për prodhimin e cimentos në ambiente të mbyllura. Pastrimi sistematik i fabrikës me fshesa mekanike për të hequr pluhurin që mbledhet në rrugë dhe ulluqe	Asnjë	Ndikim i papërfillshëm

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

UJRRAT SIPËRFAQËSORE DHE TOKËSORE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	Larje e plotë e sipërfaqeve në rast derdhjesh të lëndëve ndotëse dhe përpunim i mëtejshëm e specifik i ujrave të mbledhura. <u>Për karierat:</u> Mbledhja dhe transporti i duhur i lëndëve ndotëse (p.sh: lëndë vajore dhe lubrifikuese të harxhuara, etj.)		
Ndotja e ujrave sipërfaqësorë si pasojë e shkarkimit të ujrave të zeza të dëmshme / të papërpunuara.	Sistemi i përpunimit të ujrave të zeza do të përballojë kërkesat kulmore gjatë fazës ndërtimore; dhe si e tillë, do të përballojë edhe kërkesat gjatë fazës operacionale. Në sistemin e përpunimit të ujrave të zeza nuk do të shkarkohen lëndë të lëngshme të rrezikshme. Sigurimi i një rezervuari të madh balancues para shkarkimit përfundimtar do të shërbejë si njësi për ruajtje në rast të shkarkimeve aksidentale në sistemin e përpunimit të ujrave të zeza.	Asnjë	Ndikim i papërfilshëm
Erozioni i tokës	<u>Për fabrikën e cimentos:</u> N/A <u>Për karierat:</u> Rehabilitim gradual i terreneve në të cilat ka përfunduar procesi i nxjerrjes së	Erozion i kufizuar në terrenin e karierave.	Ndikim negativ i vogël

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

UJRRAT SIPËRFAQËSORE DHE TOKËSORE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	lëndës së parë.		
Ndotja e tokës dhe ujrave tokësore	<u>Për fabrikën e cimentos dhe karierat:</u> Veshje dytësore për lëndët e mundshme ndotëse. Shtresa sipërfaqësore e tokës së ndotur hiqet e depozitohet në zonat e mbetjeve të rrezikshme.	Ndotje e kufizuar në terrenin e zhvillimit.	Ndikim negativ i vogël
Shterimi i burimeve ujore tokësore.	<u>Për fabrikën e cimentos dhe karierat:</u> Përdorimi i ujrave sipërfaqësorë për të mbuluar kërkesat për ujë gjatë proceseve industriale nuk shihet si alternative, pasi ujjrat tokësorë janë rezervat e përshatshme ujore për këtë proces. Nxjerrja e kontrolluar e ujit nga pusët brenda dhe jashtë zonës së zhvillimit në fushat e Burizanës.	Shkalla e shfrytëzimit të rezervave ujore tokësore për qëllime të furnizimit me ujë dhe vaditje, i tejkalon kërkesat për ujë për prodhimin e cimentos.	Ndikim i papërfilshëm

CILËSIA E TOKËS			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Shkarkimi/clirimi aksidental i lëndëve djegëse, vajore, kimike, lëndëve të rrezikshme, etj në tokë, veçanërisht në zonën e ndërtimit	Vendosja e procedurave dhe protokolleve të duhura si dhe monitorimi i transportit dhe trajtimit të materialeve	Potenciali për shkarkimet/clirimet aksidentale gjatë transportit të materialeve në zonë do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

CILËSIA E TOKËS			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
gjatë transportit			
Shkarkimi/clirimi aksidental i lëndëve djegëse, vajore, kimike, lëndëve të rrezikshme, etj në tokë, gjatë magazinimit	Të gjitha zonat e magazinimit do të kenë masat e duhura të sigurisë mjedisore për të parandaluar shkarkime aksidentale në tokë	Potenciali për shkarkimet/clirimet aksidentale gjatë magazinimit do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Shkarkimi/clirimi aksidental i lëndëve djegëse, vajore, kimike, lëndëve të rrezikshme, etj në tokë, vecanërisht në zonën e ndërtimit, gjatë transportit për në vendin e përdorimit	Vendosja e procedurave dhe protokolleve të duhura si dhe monitorimi i transportit dhe trajtimit të materialeve për sa kohë janë në zonën e zhvillimit	Potenciali për shkarkimet aksidentale të materialeve gjatë transportit dhe trajtimit të lëndëve brenda zonës së zhvillimit do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Shkarkimi/clirimi aksidental i lëndëve djegëse, vajore, kimike, lëndëve të rrezikshme, etj në tokë, gjatë përdorimit psh rimbushja me lëndë djegëse, mirëmbajtja, etj.	Vendosja e procedurave dhe protokolleve të duhura si dhe monitorimi i trajtimit dhe përdorimit të materialeve. Aty ku është e mundur, zonat e furnizimit me lëndë djegëse dhe zonat e shfrytëzuara për mirëmbajtje do të sigurohen me masa dytësore të kontrollit.	Potenciali për shkarkimet aksidentale të materialeve gjatë përdorimit do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Derdhjet aksidentale të mbetjeve të lëngshme gjatë largimit nga zona	Vendosja e procedurave dhe protokolleve të duhura dhe monitorimi i largimit të mbetjeve nga zona.	Potenciali për shkarkimet aksidentale të mbetjeve gjatë largimit nga zona do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël
Derdhje aksidentale e ujrave të zeza (sanitare) dhe ujrave të ndotur në tokë	Ujrat e zeza (sanitare) nuk do të shkarkohen në tokë. Do të ndërtohen puse të shkarkimit dhe gropa të mbledhjes së ujrave të zeza.	Asnjë	Ndikim i papërfillshëm / Zero

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

CILËSIA E TOKËS			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	Inspektimi periodik i kanalizimeve		
Shkarkimi i ndotësve në tokë nëpërmjet ujit që përdoret për veprimtarinë e fabrikës, pajisjeve dhe larjes së makinave	Aktivitetet larëse do të zhvillohen në zona me masa të përshtatshme kontrolli, me procedura e protokolle që do të përcaktohen e monitorohen për të garantuar se masat parandaluese janë efikente.	Potenciali për shkarkimin aksidental të ndotësve në tokë gjatë aktiviteteve larëse do të minimizohet	Ndikim negativ i vogël

EKUILIBRI MIDIS ENERGJISË DHE CLIRIMIT TË GAZEVE ATMOSFERIKE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Përdorimi i lëndës djegëse të ngurtë dhe clirimi direkt apo indirekt i clirimeve atmosferike	Garantimi se procesi i djegies dhe përpunimit është eficient dhe i realizueshëm nëpërmjet aktiviteteve të mirëmbajtjes.	Clirimet e atmosferike	Ndikim negativ i moderuar

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

PËRDORIMI I MATERIALEVE DHE MANAXHIMI I MBETJEVE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Ruajtja/magazinimi i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme	Inspektim i të tërë zonave të grumbullimit të mbetjeve për të garantuar izolimin e mbetjeve dhe kontrollin	Shkarkimet potenciale në mjedis	Ndikim negativ i vogël
Manaxhimi i mbetjeve	Nxjerrja e licensave dhe lejeve të manaxhimit të mbetjeve të ngurta Vendosja e teknikave të manaxhimit të mbetjeve mbi largimin / reciklimin e mbetjeve dhe përzgjedhja e kontraktorit të të duhur Vendosja e procedurave mbi trajtimin e filtrave të pluhurit dhe përzgjedhja e kontraktorëve Përcaktimi i teknikave të largimit të mbetjeve të rrezikshme Shqyrtimi i alternativave të minimizimit të mbetjeve dhe reciklimit për të gjitha tipet e mbetjeve	Manaxhimi i mbetjeve do të kryhet nëpërmjet procedurave të brendshme dhe do të rregullohet nëpërmjet rregulloreve të qeverisjes vendore Rritja e sasisë së mbetjeve që do të largohen nga zona Rritja e reciklimit / ripërdorimit të mbetjeve të prodhuara	Ndikim negativ i vogël

EKOLOGJIA			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Zona e Burizansës – Terrenet e Fabrikës së Cimentos dhe Karierave			

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

EKOLOGJIA			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Depozitimi i pluhurit në gjethet e pemëve që çon në dobësimin e prodhimtarisë së bimësisë dhe dëmtimin shëndetit.	Brez me pemë për të bërë një ndarje lokale. Ulja e cilimit të pluhurave që në burim.	Përhapja e pluhurit në zonën e karierave gjatë aktiviteteve shpërthyes, etj., është e paevitueshme, por shkalla e përhapjes dhe ndikimeve të tyre	Ndikim negativ i vogël
Ulja e prodhimtarisë dhe cilësisë së bimësisë për speciet barngrënëse	Rrugë të asfaltuara që çojnë në karriere	mund të mbahen në një nivel të pranueshëm si rezultat i përdorimit të teknologjive të fundit dhe praktikave më të mira të punës.	
Prishja e qetësisë së kafshëve nga zhurmat	Zvogëlim në burim	Një pjesë e kafshëve mund të mësohen me uljen e zhurmës, ndërsa specie të tjera më të ndjeshme mund të largohen nga zona e projektit.	Ndikim negativ i vogël
Prishja e qetësisë së kafshëve nga prania e njerëzve dhe aktiviteteve	Program edukativ mbi çështjet mjedisore Ekolog në zonën e zhvillimit	Nuk parashikohet pajtueshmëri e plotë për sa kohë ekziston gjuetia dhe mbledhja e bimëve në mënyrë të paligjshme. Një pjesë e kafshëve janë të mësuara me praninë e njeriut, ndërsa specie të tjera më të ndjeshme mund të largohen nga zona e projektit.	Ndikim negativ i vogël – ndikim i moderuar
'Vrasjet aksidentale rrugore' të kafshëve	Vrojtim ekologjik Metodologji ekologjike Shenja paralajmëruese rrugore Udhëzime për drejtuesit e automjeteve	Vrasjet aksidentale rrugore të kafshëve duhet të ulen por një pjesë e tyre janë ende të paevitueshme.	Ndikim negativ i vogël

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

NDIKIME PEIZAZHORE DHE VIZUALE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Dëmtim i karakterit peizazhor dhe bukurisë pamore për shkak të prezantimit të tipareve dhe aktiviteteve që nuk janë në harmoni me peizazhin	Heqja e ndricimit dhe minimizimi i orëve të punës gjatë natës Ngjyrimi i ndjeshëm i fabrikës dhe automjeteve Minimizimi i periudhës kohore midis fazës së shfrytëzimit dhe rehabilitimit të karrieres.	Ndryshim i karakterit peizazhor dhe humbjes së bukurisë, kryesisht si rezultat i aktiviteteve jashtë zonës së zhvillimit.	Ndikim negativ i vogël – ndikim i moderuar

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

TRAFIKU DHE TRANSPORTI			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Rritja e trafikut të mjeteve të rënda në nivel lokal dhe kombëtar	Shfrytëzimi maksimal i rrjetit hekurudhor për ngarkesat e paambalazuara (rifuzo) dhe ngarkesat tepër të mëdha. Kufizimi i orëve të transportit për të ulur zhurmat; shmangia e qarkullimit të kamionëve gjatë orëve të natës. Shqyrtimi i mundësisë së planifikimit logjistik të transportit për të shmangur orët e pikut dhe për të ulur bllokimin e trafikut. Trafiku i mjeteve të rënda ndërtimore do t'i nënshtrohet një plani të manaxhimit të trafikut, sipas nevojës.	Trafiku ka gjithë potencialin për të kontribuar në bllokimin e trafikut dhe rritjes së ankesave të komunitetit si rezultat i zhurmës/vibrimit. Sidoqoftë, studimi i transportit dëshmon se nuk do të ketë ndikime domethënëse.	Ndikim negativ i vogël

ZHURMA DHE VIBRIMI			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Zhurmë nga fabrika e cimentos	Nuk rekomandohet asnjë masë, vec në se fabrika dhe pajisjet e saj ndryshojnë thelbësisht nga ato të fabrikës së Selanikut.	Nuk parashikohet asnjë	Zero
Zhurmë nga aktivitetet e karierave	Manaxhimi i mirë i zonës; Zgjedhja e duhur e makinerive; Metodat e punës;	Mund të ketë rritje të zhurmës në zonat e banuara që shtrihen pranë vendodhjes së karierave.	Ndikim negativ i vogël

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

ZHURMA DHE VIBRIMI			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	Orët e punës; Trajtimi me efikasitet të materialeve; Ndërtimi i barrierave të zhurmës ose kodërza penguese të zhurmës;		
Zhurmë nga shtimi i trafikut në rrjetin rrugor lokal e më gjerë	Nuk rekomandohet asnjë masë në rrugët ekzistuese pasi nuk parashikohet ndonjë rritje e shkallës së zhurmës si rezultat i shtimit të trafikut.	Nuk parashikohet asnjë ndikim në rrugët ekzistuese. Rritja e shkallës së zhurmës në zonat e banuara pranë segmenteve të reja rrugore.	Zero
Zhurmë nga trafiku në segmentet e reja rrugore.	Nevojë për barrierë zhurme në segmentet e reja rrugore në varësi të afërsisë së tyre me zonat e banuara dhe numrit të banesave të ndikuara.	Mund të ketë rritje të zhurmës në zonat e banuara pranë segmenteve të reja rrugore.	Ndikim negativ i vogël

NDIKIME SOCIALE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Rritja e punësimit (ndryshim pozitiv)	Rekomandimi i masave për shtimin e punësimit dhe përmirësimin e kapaciteteve të komunitetit lokal. - Rekrutimi i të rinjve aktualisht të trajnuar jashtë qytetës së lindjes. - Ofrim i praktikës / trajnimeve për persona që kanë nevojë për ngritje kapacitetesh në punë - Përzgjedhja dhe prioritarizimi i	Kjo është në varësi të aftësive të të rinjve dhe interesit të tyre për t'u kthyer në qytetë të lindjes, në mundësitë që ofron Titan dhe kategorive të përcaktuara të punësimit.	Ndikim pozitiv i madh

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

NDIKIME SOCIALE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	punësimit të NJNP - Identifikimi i kategorive të rinjve që do të punësohen në bazë të aftësive. - Publikimi i kategorive të punësimit në buletin informativ lokal. - Në të ardhmen politika e rekrutimit do të përfshijë sponsorizim të pjesës së arsimit të lartë (diplomë në shkencë ekzakte (BSc) apo të tjera ekuivalente) për punonjësit / të rinjtë		
Rritja e taksës së biznesit dhe të ardhurave të bashkisë (ndryshim pozitiv)	Ofrim i asistencës për formulimin e projekteve dhe forcimin e aftësive të mbrojtjes së tyre, nëse kërkohet nga komiteti koordinues. Fitimet nga rritja e të ardhurave në buxhet mund të përdoren për të përmbushur këto objektiva. Antea Cement do të ofrojë trajnim për përmirësimin e kapaciteteve mbi planifikimin dhe formulimin e projekteve.	Rritja e të ardhurave bashkiake për rrethin e Krujës. Ndikimet e mbetura varen nga efikasiteti i procesit të alokimit të fondeve në ndihmë të fshatrave të ndikuara. Një proces i keqmenaxhuar mund të shkaktojë konflikte / mospëlqime.	Ndikim pozitiv i madh
Përmirësime në fushën elektrike dhe përmirësimi i tjera infrastrukturore (nëse realizohen, përmirësimi do të kenë ndikim neutral ose pozitiv)	Asnjë i identifikuar; por nëse do të ketë përfitime, ai do të jetë një përfitim 'rastësor' (apo një përfitim i jashtëm)		Ndikim neutral / ndikim pozitiv i vogël
Humbja apo ulja e mjeteve të	Konfirmim i ndikimeve të mundshme	NjNP janë shprehur për ofrimin e	Ndikim neutral / ndikim pozitiv i

NDIKIME SOCIALE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
jetesës për: Prodhuesit e gëlqeres (i papërfillshëm / ndikim negativ i vogël) Mbledhësit e bimësive (ndikim negativ i vogël) Rritësit e bagëtive (ndikim negativ i mesëm)	lidhur me ushqimin e bagëtisë, ndikimet në prodhim dhe ndërlikimet buxhetore nga specialistët e kullotave / rritësit e bagëtisë, pasuar nga inspektimi i kullotave (dhe bagëtisë) dhe vlerësimi i numrit të bagëtisë përkundrejt kërkesave për energji. Konfirmimi mbi të ardhurat nga bimët do të sigurohet nga të dhënat e shitësit grosist, ose nga studimi baze. Prioritarizimi i punësimit ose i formave të tjera të kompensimit për secilën prej familjeve të ndikuara nga zhvillimi (identifikuar në një shtojcë konfidenciale (Shtojca 2) dhe konfirmuar nga masat e mësipërme) Antea do të shohë mundësinë e skemave të ndarjes së punëve dhe ofrimit të lehtësirave për çështje gjinore (psh marrëveshje për rastet e kujdesit të fëmijëve). Monitorimi vjetor i ndryshimit të aktiviteteve dhe të ardhurave lidhur me mbledhjen e bimëve, djegien e gëlqeres dhe kullotjen e bagëtisë, si dhe ndryshime të tjera dinamike në aktivitete dhe të ardhura nga punësimi me Antea Cement. Monitorim vjetor gjatë fazës së	punësimit se sa ofrimin e formave të tjera kompensuese. Asnjë familje nuk do ta humbasë mjetin e tyre të jetesës dhe të ardhurat nga punësimi (i plotë apo i pjesshëm) i një ose më shumë anëtarëve të një familjeje apo i kompensimit alternativ do të jetë e mjaftueshme për të kompensuar uljet e parashikueshme në aktivitetet e ndikuara nga zhvillimi.	vogël

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

NDIKIME SOCIALE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	ndërtimit dhe viteve të para të funksionimit. Raportimi u bëhet investitorëve, si dhe nëpërmjet raportit SER dhe forumit koordinues. Vëmendje e vecantë do t'i kushtohet familjeve vulnerabël.		
Rreziqet që lidhen me zhvillimin e rrugëve të reja nga udhëkryqet kryesore për në fabrikën e cimentos dhe nga kariera e fllshit për në fabrikën e cimentos.	Lidhur me shkallën 'e lartë' të rreziqeve të identifikuar: • Marrja e masave për të siguruar se rrëshqitja e tokës / rënia e gurëve të mos shkaktojë aksidente • Përfshirja e rrugëkalimeve dhe vendkalimeve të këmbësorëve • Sigurimi i ndricimit, vecanërisht në udhëkryqe • Planifikimi i hyrjes dhe parkimit, vecanërisht në zonën e varrezzave dhe pelegrinazhit Ndër të tjera do të merren masa edhe për manaxhimin e qarkullimit të bicikletave dhe mjeteve që tërhiqen nga kafshët. Rreziku për aksidentet do të zvogëlohet nga zbatimi i programeve edukative (fushatë ndërgjegjësimi për sigurinë rrugore) dhe koordinimit me komunitetet	Priten efekte të mbetura por do të kufizohen nga zbatimi i masave zbutëse të lartpërmendura.	Ndikim negativ i mesëm – deri ne ndikime kritike në se shpërfillen çështjet e sigurisë për përdoruesit e rrugës.

NDIKIME SOCIALE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	vendore si dhe programe të trajnimit të drejtuesve të automjeteve dhe zbatimit të procedurave të raportimit të goditjeve / aksidenteve. Si pjesë e këtij ushtrimi, propozohet rishikimi i kontratave dhe kushteve të qeradhënies së mjeteve për transport të vecantë (me silose të mbyllura). Komuna do të vendosë për nevojën e nxjerrjes së urdhëresave apo rregulloreve të sigurisë për veprimtaritë e bizneseve lokale pranë rrugëve. Komuna të shqyrtojë nevojën për hartimin e urdhëresave apo rregulloreve lidhur me sigurinë rrugore që rregullojnë aktivitetin e bizneseve lokale pranë rrugës.		
Shëndeti dhe cilësia e jetës së banorëve	Kryerja e një vlerësimi të rrezikut që mbulon këto aspekte dhe identifikon masat zbutëse Regjistrimi i sëmundjeve - shkaktuar nga pluhurat - nga punonjësit e qendrave lokale shëndetësore. Pyetësor mbi cilësinë e jetës për të monitoruar zhurmën dhe shqetësimin Përcaktimi i masave të tjera zbutëse mbi bazën e ndikimeve të regjistruara si	Në varësi të të dy rasteve: a) efikasiteti i procesit të monitorimit b) ndërmarrja e masave korrigjuese – në varësi të rastit, psh. trajtimi mund të mos e zgjidhë problemin. Rastet më problematike shëndetësore mund të kërkojnë ri-strehim. Sidoqoftë, numri i familjeve që ka të ngjarë të preken nuk parashikohet t'i kalojë 20 familje, ndonëse pasojat për	Ndikim negativ i vogël/ mesatar

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

NDIKIME SOCIALE			
Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	pasoje e procesit të monitorimit.	individët mund të jenë të rënda.	
Zonë e trashëgimisë dhe kulturës: Boke e kuge (ndikim pozitiv)	Transporti me mjete motorike është mënyra më e lehtë për të hyrë në zonën e pelegrinazhit të Bokes së Kuge. Rruga nuk duhet të kalojë pranë zonës së zhvillimit; sidoqoftë, duhet të ofrojë mundësinë për një rrugë të re kalimi.	Përmirësimi i rrugës së kalimit, lehtësimi dhe shpejtësia e saj	Ndikim pozitiv i vogël

Përmbledhje e Ndikimeve të Mbylljes së Kantierit dhe Masat Zbutëse

Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Parandalimi i çlirimeve	Hartimi i një Plani për Mbylljen e kantierit	Plani do të përmbajë informacion të përditësuar mbi rreziqet dhe kërkesat.	Ndikim pozitiv i vogël
Përhapja e phuhurave gjatë punimeve të tokës	Spërkatja e rrugëve me ujë Mbulimi i mjeteve që transportojnë materiale që lëshojnë pluhur Kufizim shpejtësie në sipërfaqe të paasfaltuara Monitorimi i përhapjes së pluhurave në pika të caktuara.	Përhapja e pluhurit do të jetë e kufizuar në zonën e shembjes dhe nuk do të ndikojë në komunitetin vendas. Sidoqoftë, punëtorët do të pajisen me maska pluhuri, vecanërisht në ditë të thata.	Ndikim negativ i vogël
Derdhja në sipërfaqen e tokës e ujërave të bardha me përmbajtje lymore e të ndotura. Ndotja e tokës nga rrjedhjet e makinerive	Materialet që kanë potencial ndotës do të ruhen në zona magazinimi të përcaktuara Kushtet teknike të makinerive dhe pajisjeve do të rishikohen periodikisht Makineritë dhe pajisjet do të vendosen në sipërfaqje të forta. Të gjithë ujrat e bardha do të kalojnë nëpërmjet rezervuarëve të sedimentimit dhe ndarjes së vajrave Hartimi i procedurave për gjetjen e materialeve të ndotura gjatë gërmimeve. Mbulimi dhe njomja e materialeve të	Ndotja e tokës dhe ujërave të bardha do të kufizohet nëpërmjet trajtimit dhe ruajtjes së duhur të materialeve dhe pajisjeve. Ujrat e bardha do të përpunohen në rezervuarët e sedimentimit, ndaj ndikimet në cilësinë e përgjithshme të derdhjes së do të jenë minimale.	Ndikim negativ i vogël

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
	ekskavuar Magazinimi i materialeve të ndotura, nëse gjenden të tilla		
Prishja e habitateve të lakuriqëve të natës ose zogjve që mund të kenë kolonizuar strukturat e fabrikës së cimentos	Vrojtim, zhvendosje, prishje e habitateve në periudha të përshtatshme të vitit	Ndikim në procesin e mbarështimit gjatë përshtatjes në zonat e zhvendosjes	Ndikim negativ i vogël
Humbje e florës dhe faunës që ka filluar të ri-kolonizojë vendodhjen e karierës	Plan për Rehabilitimin e Karierës që përfshin krijimin e habitateve. Programi i rehabilitimit të karierës do të jetë e vazhdueshme e do të ndjekë afatet kohore të përcaktuara nga autoritetet e planifikimit.	Plani i Rehabilitimit të Karierës me përfshirjen e krijimit të habitateve dhe përdorimit të specieve vendase.	Në varësi të shfrytëzimit të ardhshëm të karierës, krijimi i habitatit mund të çojë në përmirësime domethënëse e vlera të larta biodiversiteti krahasuar me përdorimin e zonës si karriere aktive
Dëmtim i karakterit peizazhor dhe bukurisë pamore si pasojë e vecorive dhe veprimtarive të papërshtatshme	Rehabilitimi i zonës së fabrikës dhe karierave duke përfshirë një program rryllëzimi	Kthimi i zonës në kushte më të mira se ato ekzistuese	Ndikim pozitiv i vogël
Prodhimi i mbetjeve të ngurta	Vecimi/ndarja dhe reciklimi i mbetjeve dhe ruajtja e tyre në vende të izoluar nga toka	Mbetjet e ngurta do të manaxhohen nga një firmë nënkontraktore dhe do të depozitohen përkundëjt lejeve të posacme	Ndikim pozitiv i vogël
Zhurma dhe shkarkime prodhuar nga mjetet	Plan për manaxhimin e trafikut Shfrytëzimi i transportit hekurudhor për transportin e materialeve të paambalazuara dhe ngarkesave shumë të mëdha	Shmangie e problemeve që lidhen me bllokimin e trafikut lokal	Ndikim negativ i moderuar

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Ndikimi Mjedisor	Masa Zbutëse e Propozuar	Efekti i Mbetur	Shkalla e Vlerësimit të Efektit të Mbetur
Zhurmë nga demolimi i fabrikës dhe karierave	Manaxhimi i mirë i kantierit; Zgjedhja e duhur e makinerive; Metodat e punës, përfshirë shpërthimet e njëpasnjëshme; Orët e punës; Trajtimi me efikasitet të materialeve; Ndërtimi i barrierave të zhurmës ose kodërza penguese të zhurmës; Maksimizimi i distancave ndarëse	Derisa të merren vesh detaje të mëtejshme, nuk është e mundur të parashikohet nëse do të ketë rritje të zhurmës në shtëpitë e banorëve përreth.	E pazbatueshme (N/A)
Situata emergjente gjatë punëve ndërtimore	Skuadra zjarrëfikësish dhe emergjence të gatshme në terren. Gatishmëria në terren e Antea-s dhe inspektorëve të kontraktorëve.	Zbatimi i procedurave për parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente. Personeli do të trajnohet e do të pajiset me mjetet e nevojshme.	Ndikim negativ i vogël
Ndikime sociale Do të humbasin vende pune	Një strategji daljeje duhet të hartohet për të minimizuar humbjen e punës dhe gjetjen e zgjidhjeve për ripunësim. Strategjia duhet të përfshijë alternativa për trajnime të tjera / dalje e parakohëshme në pension / asistencë në gjetjen e punëve / identifikim të punëve brenda grupit dhe asistencë për zhvëndosje të mundshme.	Hartimi i planeve për ri-punësimin e punëtorëve	Ndikim negativ i moderuar

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Plani i Monitorimit Mjedisor e Social gjatë Fazës Ndërtimore

Cështja	Masat	Përgjegjësia	Periodha
Zhurmë/vibrim nga trafiku që shoqërohet me fazën ndërtimore	Sigurimi se qarkullimi i automjeteve që lidhen me fazën ndërtimore të kalojnë vetëm në itinerarin e para-përcaktuar derisa të përfundohen segmented rrugore lidhëse. Pas përfundimit të segmenteve rrugore lidhëse, i gjithë qarkullimi i automjeteve për në / nga zona do të kalojë vetëm në këto rrugë.	Kontraktori	Gjatë fazës ndërtimore
Pluhuri	Është e nevojshme që konsulenti të kryejë vëzhgime vizuale të ngritjes së pluhurit gjatë gjithë fazës ndërtimore. Të gjitha aktivitetet, para fillimit të tyre, duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi për mundësinë e ngritjes së pluhurit. Është me rëndësi vëzhgimi i kushteve të motit.	Kontraktori/ Antea	Gjatë gjithë fazës së ndërtimit por vecanërisht gjatë kryerjes së veprimtarive apo përpunimit të materialeve që mund të shkaktojnë probleme të përhapjes së pluhurit
Komunikimi	Hapja dhe përditësimi i një regjistri për regjistrimin e të gjitha komunikimeve lidhur me çështjet mjedisore dhe sociale, përfshirë ankesat. Kjo do të arrihet nëpërmjet mekanizmit ekzistues të mbledhjes së ankesave.	Antea	Marrja e masave parandaluese dhe korrigjuese, në se është e nevojshme. Veprimet do të regjistrohen në regjistër.
Aksidentet dhe incidentet	Hapja dhe përditësimi i një regjistri mbi aksidentet dhe incidentet mjedisore	Antea	Marrja e masave parandaluese dhe korrigjuese, në se është e nevojshme. Veprimet do të regjistrohen në regjistër.
Mbetjet	Inspektime vizuale të zonave të ruajtjes, grumbullimit dhe largimit të mbeturinave. Regjistrimet të bëhen në bazë të inspektimeve.	Antea	Inspektime mujore. Marrja e masave parandaluese dhe korrigjuese, në se është e nevojshme.
Mbetjet e lëngshme	Sigurimi se impianti i propozuar i përpunimit të mbetjeve ka specifika të posacme teknike për të	Antea	Sapo të jetë e disponueshme projektimi i impiantit të përpunimit të mbetjeve dhe

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vleresim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Cështja	Masat	Përgjegjësia	Periudha
	parandaluar ndikime domethënëse në vijat e lundrueshme. Kur të bëhen të disponueshme detajet e impiantit të përpunimit të mbetjeve, operatori do të kërkohej të paraqesë detajet e plota të impiantit (përfshirë kërkesat e manaxhimit të tij), kapacitetit të pritshëm, cilësinë e shkarkimeve, pikën e shkarkimeve, cilësinë e rezervave ujore në të cilat ato shkarkohen dhe ndikimet e mundshme në të.		para se të jepet në dorëzim për përdorim gjatë fazës ndërtimore për pjesën tjetër të zhvillimit
Zonat e magazinimit	Inspektime vizuale të të gjitha zonave të magazinimit të materialeve (përfshirë lëndën djegëse). Regjistrimet të bëhen në bazë të inspektimeve.	Antea	Inspektime mujore. Marrja e masave parandaluese dhe korrigjuese, nëse është e nevojshme.
Ekologjia Tokësore	Brez pemësh për të siguruar ndarjen Program edukativ mbi mjedisin Monitorimi i lëvizjes së kafshëve në rrugët e hyrjes në zonë Monitorimi i zonës së karrieres Monitorimi i Programeve të Rehabilitimit të Habitave	Antea/ Specialisti i Titan Drejtuesi i automjetit Specialisti	Cdo 2 javë Cdo 2 javë Cdo 2 javë (përpara periudhës së pastrimit) Raportim mujor dhe vjetor
Ekologjia Detare (Porti)	Monitorimi i mjeteve të transportit (praktikat e largimit të mbetjeve) Monitorimi i objekteve të largimit të mbetjeve të ngurta e të lëngshme në tokë	Antea/Titan	Rishikimi i përditshëm i dokumentacionit dhe kontrole në terren Cdo 6 muaj kontrole sporadike në terren
Social-Ekonomike: Planifikimi i kampit	Provision of camp specification and plans against international "norms" Rishikimi i specifikave dhe identifikimit të amendimeve	CBMI Titan do t'i rishikojë në bazë të këshillave nga Forumi	Përpara zhvillimit të kampit Përpara zhvillimit të kampit

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vleresim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Cështja	Masat	Përgjegjësia	Periodha
	Hartimi / pëlqimi i kodit të sjelljes dhe dorëzimi në Forumin Koordinues	Koordinues CBMI	Përpara zhvillimit të kampit
Social-Ekonomike: Kushtet standarde të strehimit të punëtorëve të ndërtimit *	Pyetësor drejtuar punëtorëve dhe inspektime	Titan	Cdo tremujor
Social-Ekonomike: Kushtet standardë të furnizimit me ushqime / gatimit për punëtorët e ndërtimit*	Pyetësor drejtuar punëtorëve dhe inspektime	Titan	Cdo tremujor
Social-Ekonomike: Cilësia e jetës së punëtorëve të ndërtimit*	Pyetësor drejtuar punëtorëve, vizita në terren Ky pyetësor e tipe të tjera pyetësorësh do të kryhen nga një folës i gjuhës kineze, i trajnuar e me përvojë në standardet dhe cështjes e punës.	Titan	Cdo tremujor
Social-Ekonomike: Cilësia e jetës së punëtorëve të ndërtimit*	Propozimet e sugjeruara të punëtorëve të ndërtimit do të depozitohen në kuti të posacme	Titan /Antea dhe kompania kontraktore CBMI	Në mënyrë të vazhdueshme
Social-Ekonomike: Cilësia e jetës së banorëve vendas	Krijimi i një forumi apo komiteti koordinues, anëtarët e të cilit të jenë: përfaqësues të komunitetit, të autoriteteve lokale, të autoriteve shëndetësore, përfaqësues nga Antea e përfaqësues të kampit të ndërtimit Monitorimi i rregullt i cështjeve / shqetësimeve të mundshme (përfshirë aksidentet rrugore, mundësinë e transportit lokal, aspektet shëndetësore, konfliktet e mundshme dhe cështje të tjera), duke identifikuar masat parandaluese dhe veprimet emergjente.	Antea, kompania kontraktore CBMI, kryetari i bashkisë Krujë dhe Kryetari i Thumanës	Cdo muaj

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Cështja	Masat	Përgjegjësia	Periudha
Social-Ekonomike: Monitorimi i aspekteve shëndetësore	Identifikimi i treguesve dhe sigurimi i statistikave të shëndetit të punëtorëve	Doktori i kampit	Cdo muaj
Masa të sigurisë rrugore	Zbatimi i masave fizike të propozuara në Studimin e Sigurisë Rrugore për të minimizuar rreziqet e sigurisë rrugore. Zbatimi i fushatës së ndërgjegjësimit mbi çështje të sigurisë rrugore. Komentet e banorëve do të përfshihen e do të merren parasysh në fazën përfundimtare të projektimit / çështjeve të sigurisë. Sigurimi se kontratat e drejtuesve të automjeteve lidhen me përgjegjshmërinë e drejtimit të automjeteve. Zbatimi i fushatave të sigurisë rrugore / trajnimeve për drejtuesit e automjeteve para fazës operacionale.	Antea	Projektimi dhe ndërtimi i rrugëve, para fazës operacionale
Social-Ekonomike: Procesi i kompensimit të banorëve që do të preken nga rruga e re	Të verifikohet që : - Broshura me përfitimet - Deklarimi i procesit - Dokumenti i vlerësimit nga FShV - Tabela e përfitimeve Të jenë përgatitur me të gjitha detajet e duhura dhe tu shpërndahen të gjitha palëve të interesuara. • Procesi i ankimit – numri i ankesave / çështjeve të evidentuara dhe gjendja e tyre	Kryetari dhe juristi i këshillit të komunës së Thumanës Kryetari i komunës Raportimi në këshillin e komunës dhe në forumin koordinues Drejtori i sektorit të shërbimeve publike dhe juristi i komunës së Thumanës	Në periudha të specifikuara për hartimin e informacionit në Tabelën 8.6. Cdo muaj deri në përfundim të ndërtimit Në datat e vendosura në procesin e kompensimit

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Cështja	Masat	Përgjegjësia	Periudha
	Monitorimi i procesit të kompensimit të ndërmerret nga komuna. Raporti t'i paraqitet Antea-s për raportin vjetor që përgatitet për investorët si dhe banorëve vëndas.		
	Monitorimi i procesit të transaksioneve të kompensimit do të kryhet nga komuna. Komuna i raporton Antea-s për raportimin vjetor ndaj investitoreve dhe banorëve vendas.		

Plani i Monitorimit Social e Mjedisor të Fazës Operacionale

Cështjet	Masat	Përgjegjësia	Afati
	Monitorim i vazhdueshëm i parametrave kryesore dhe vrojtim në vend i parametrave dyrësore Pajisjet e monitorimit dhe metodat do të jenë në përputhje me: _ Kërkesat kombëtare shqiptare _ Dokumentin BREF të BE-së për Industrinë e Përpunimit të Cimentos dhe Gëlqeres. _ Udhëzimet që parashtrohen në Udhëzimet mbi Mjedisin, Shendetin dhe Sigurinë të KFN-së për Përpunimit të Cimentos dhe Gëlqeres.	Antea	Gjatë gjithë fazës operacionale të fabrikës që nga faza e demolimit deri në fazën e mbylljes së fabrikës.
Clirimet në ajër nga oxhaku kryesor	Clirimet mesatare ditore të ajrit nga oxhaku kryesor nuk duhet të tejkalojë vlerat parësore kufizuese (mg/Nm³): _ Grimca 30 _ Pluhuri: 50 _ SO₂: 400 _ NO_x: 600 Operatori gjithashtu duhet të respektojë vlerat kufizuese dytësore (HCl, fluorur hidrogjeni, dioksins-furans etj) sic parashikohen në Udhëzimet e KFN-së mbi MShS Marrja në shqyrtim e nevojës për instalim të pajisjeve lehtësuese të clirimeve nga fabrika e	Antea Antea	Gjatë gjithë fazës operacionale të fabrikës që nga faza e demolimit deri në fazën e mbylljes së fabrikës. Raporti duhet t'u dorëzohet KFN dhe BERZH brenda 3 viteve nga data e fillimit të fabrikës së cimentos.

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Cështjet	Masat	Përgjegjësia	Afati
	cimentos. Operatori kërkohet të paraqesë një raport i cili shqyrton clirimet nga fabrika përkundrejt parametrave etalon, zvogëlimin potencial të cilësisë së ajrit përreth si pasojë e clirimeve dhe ndikimin në receptorët e ndjeshëm. Vlerësimi gjithashtu duhet të marrë në konsideratë veprimet e propozuara në të ardhmen e fabrikës, vecanërisht lidhur me lëndën kryesore djegëse ëe përdoret.		
Clirimet e pluhurit fluturues në ajër	Vrojtim i vazhdueshëm me sy të lirë dhe vlerësim i rregullt vizual i përhapjes së pluhurave	Antea	Gjatë gjithë fazës operacionale të fabrikës që nga faza e demolimit deri në fazën e mbylljes së fabrikës.
Zhuma gjatë fazës operacionale – Shëndeti dhe Siguria	Programi i monitorimit të zhurmës. Matja e niveleve të zhurmës në zonat operacionale të fabrikës dhe rreziku i dëmtimit të dëgjimit si pasojë e zhurmave të larta. Stafi që punon në zonat me nivele të larta zhurme duhet të trajnohet e t'i nënshtrohet kontrolleve mjekësore të dëgjimit.	Operatori	Identifikimi i zonave me nivele të larta zhurme dhe verifikimi i tyre kur te fillojë faza operacionale e fabrikës. Trajnimet për stafin dhe kontrollet mjekësore të dëgjimit duhet të jenë të vazhdueshme. Antea Cement po bashkëpunon me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Krujë për të përcaktuar zonat e degraduara pyjore që do të mbillen sipas përcaktimeve të saj.
Mbrojtja e tokës dhe ujrave tokësore	Lëndët djegëse, lëndët kimike, lëndët e lëngshme dhe materialet e rrezikshme duhet të ruhen në zona të posacme. Rimbushja me lëndë djegëse do të kryhet me ndihmën e një mekanizmi kërkimor të lëvizshëm me kontrolle të përshtatshme dytësore dhe mekanizma për mbrojtjen nga derdhjet. Mirëmbajtja e fabrikës dhe larja e	Antea	Përdorimi i veshjeve dytësore të kontrollit për të gjitha cisternat dhe kontenierët e magazinimit me kapacitet mbi 20 litra (përfshirë zonat e ngarkimit). Këto mjete duhet të kenë sipërfaqe të padepërtueshme, pa hapësira, carje apo të plasaritura, dhe materiali i tyre duhet të përshtatet me tipin e lëndës që ata përmbajnë. Kapaciteti total rifuzo duhet të jetë të paktën 110% e vëllimit të kontenierit ose cisternës më të madhe në zonën e magazinimit; Marrja në konsideratë e mirëmbajtjes së duhur të

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vleresim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Cështjet	Masat	Përgjegjësia	Afati
	fabrikës/automjeteve do të kryhet në vende të posacme me mekanizma që kontrollojnë derdhjet.		veshjeve dytësore të kontrollit për të mos lejuar akumulimin e mbetjeve, bimësisë, derdhjes së lëndëve të rrezikshme dhe ujrave të bardha; Pikat që përdoren për ngarkimin e mallit do të mbulohen me cati ose streha të tjera për të minimizuar kontaktin me ujrë sipërfaqësore; Të gjitha objektet e magazinimit duhet të jenë larg vendit të kryerjes së punimeve dhe rrugëve të ngarkuara me qarkullimin e automjeteve;
			Këto zona duhet të mbahen të thata dhe pa materiale të djegshme; hyrjet, daljet dhe ishujt e shpëtimit duhet të jenë të lira dhe pa pengesa; Duhet të ketë dritë dhe ventilim të përshtatshëm; Në këto zona nuk duhet të ketë hyrje të paautorizuara; Të gjitha derdhjet dhe rrjedhjet duhet të pastrohen menjëherë; Materialet e rrezikshme duhet të magazinohen larg zonave të tjera të magazinimit. Të gjitha objektet e magazinimit dhe objektet e tjera përkatëse do të jenë të pajisura me kuti të ndihmës së shpejtë (vegla pune). Punëtorët do të trajnohen për përdorimin e tyre. Të gjitha objektet e magazinimit duhet të inspektohen vizualisht, të paktën cdo muaj, dhe cdo inspektim duhet të regjistrohet.
Cështje peizazhore	Monitorimi i erozionit dhe përcaktimi i një skeme për mbjelljen, duke përfshirë mbjelljen paraprake	TITAN	Në pritje të miratimit

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Cështjet	Masat	Përgjegjësia	Afati
dhe vizuale	me qëllim uljen e erozionit për shkak të shpyllëzimit. Monitorimi i fidanishtes brenda dhe jashtë zonës me kufirin e lejueshëm të mosrealizimit deri në 10% në vit. Hyrja në zonë nëpërmjet rrugëve të propozuara të kalimit për të ulur shfrytëzimin e jashtëligjshëm të karierave. Ndarja e shfrytëzimit të karierave në faza dhe rehabilitim i lokalizuar për të minimizuar sipërfaqen e ekspozuar të karrierës dhe hapësirën kohore midis nxjerrjes së lëndës së parë dhe asaj të rehabilitimit. Monitorimi i biodiversitetit nëpërmjet vërtetimeve vjetore.		
	Monitorimi i ndikimeve të ndricimit nëpërmjet vërtetimeve gjatë natës		
Mbetjet	Për të gjitha llojet e mbetjeve (të ngurta dhe të lëngshme) duhet të mbahen të dhëna për: Sasitë e mbetjeve Forma fizike dhe kontenierët që do të përdoren / paketimi Itinerari i largimit / trajtimit Vendi përfundimtar i depozitimit Sasitë e recikluara/ripërdorura	Antea	Të dhënat dhe raporti i monitorimit në përputhje me këtë PMM do t'i raportohet kreditorëve në Raportin Vjetor të Monitorimit

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Cështjet	Masat	Përgjegjësia	Afati
	Monitorimi/inspektimi i objekteve/repartëve të largimit/trajtimit të mbetjeve që prodhohen në fabrikë në përputhje me lejet/licensat e legjislacionit përkatës Cdo shkelje e kërkesave ligjore, përfshirë lejet, duhet të raportohen menjëherë.		
Ujrat e ndotura	Inspektim i rregullt i kanalizimeve dhe rezervuarëve të grumbullimit të mbetjeve (ku përfshihen edhe të brendshmir) do të përfshihet në planin e monitorimit të ujrave të ndotura.	Antea	Shpeshtësia dhe metodat do të përcaktohen përpara fillimit të punës në fabrikë Të dhenat dhe raporti i monitorimit në përputhje me këtë Plan të Manaxhimit të Mjedisit do t'i raportohet kreditorëve në Raportin Vjetor të Monitorimit
Energjia	Inspektimet rutinë të energjisë së brendshme në fabrikë; testimi dhe ndezja e furrave dhe bojlerëve, etj, do të kryhen cdo vit nga ekspertë. Manaxhim eficient i sistemit të energjisë. Kryerja e një studimi të detajuar të efikasitetit të fabrikës në fazën operacionale për të vlerësuar nëse është e mundur recuperimi i nxehtësisë për prodhimin e energjisë.	Antea	Të dhenat dhe raporti i monitorimit në përputhje me këtë PMM do t'i raportohet kreditorëve në Raportin Vjetor të Monitorimit Rekomandim - ky vlerësim të kryhet dhe të dorëzohet dy vjet pasi fabrika të jetë duke ushtruar veprimtarinë e saj.

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Cështjet/Kriteret e performancës	Masat	Përgjegjësia	Afati
NjNP	Monitorimi i të ardhurave të familjeve vulnerabël gjatë procesit ndërtimor dhe operacional Ekspert i prodhimit blegtoral për identifikimin e pyetjeve bazë dhe monitorim Monitorimi i prodhimtarisë dhe fitimet nga shitjet gjatë fazës ndërtimore dhe operationale duke identifikuar cdo lloj arsyeje përveç projektit që ndikon në të. Mekanizmi i ankimit ose sistemi i treguesve do të vendoset nëpërmjet forumit dhe përfaqësuesve të fshatit.	Titan Specialist prodhimi punësuar nga Titan Specialisti Forumi koordinues	Dy herë në vit Cdo tremujor Pyetjet bazë dhe mbledhje informacioni gjatë vizitës fillestarë në kullotë për përcaktimin e ndikimeve, e më pas raportime tremujore Raport tremujor – raporte më të shpeshta në se kërkohen nga përfaqësuesi
Punësimi dhe masa të tjera kompensuese	Monitorimi i punësimit lokal dhe niveli i kapaciteteve përkundrejt grupeve profesionale Punësimi i NjNP, cdo lloj arsye për mospunësim duhet të bëhen të ditura dhe zgjidhjet alternative duhet të raportohen. Forumi do të marrë vendime në rast kontaktimi nga NjNP.	Titan, Forumi koordinues Titan monitoron dhe i raporton Forumin	Një herë në vit Cdo muaj derisa të gjithë NjNP të punësohen
Politikat e komunikimit dhe angazhimit të grupeve të interesit	Pyetësorët për nivelin e dobishmërisë së veprimtarive të evidentuara në planin e komunikimit do të plotësohen dhe do të përmbledhen nga forumi dhe rezultatet e pyetësorëve do të raportohen në veprimtaritë për përgjegjësinë sociale korporative të Titan si dhe raportet përkatës të Antea-s	Forumi koordinues/Titan	
Rruga e re	Gjendja shëndetësore e banorëve me shtëpi pranë rrugës Nr. i vizitave dhe rastet e diagnostifikuara.	Drejtor i Qendrës Shëndetësore, Thumanë, i raporton forumit koordinues	Cdo tre muaj

Projekti Antea:

Zhvillimi i Fabrikës së Prodhimit të Cimentos dhe Karierave të Shfrytëzimit, Shqipëri
Vlerësim i Ndikimeve Mjedisore e Sociale (VNMS) - PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE

ATKINS

Cështjet/Kriteret e performancës	Masat	Përgjegjësia	Afati
	Ndikim sipas grupmohave		
	Cilësia e jetës nga banorët që jetojnë buzë rrugës (zhurma dhe shqetësimet) Pyetësor (hartuar nga një specialist i pavarur) Kryerja, analizimi dhe rekomandimet nga një organizatë e pavarur, kontraktuar nga Titan. Monitorimi i numrit të goditjeve / aksidenteve që lidhen me transportin për në dhe nga zona në të dy rrugët. Identifikimi i vendeve kyce të aksidenteve / vendeve potenciale të aksidenteve Masa të detajuara ndërmerren për të bërë përmirësime të tjera në sigurinë rrugore.	Titan / Komuna e Thumanës nxisin raportimin. Raportimi i drejtohet Forumit Koordinues i cili vendos për masat që duhen marrë Koordinatori i Antea-s për çështje të Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë	Cdo vit